



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 74/5 Prot

Durrës, më: 30.03 .2026

V E N D I M

Nr. 45 , datë 30.03 .2026

PËR

**"MIRATIMIN E PROJEKT - STRATEGJISË SË PROFILIZIMIT TË FAKULTETIT
TË EDUKIMIT, PËRMES NDËRKOMBËTARIZIMIT, 2025-2030"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*", të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së; të Vendimit të Senatit Nr.174, datë 17.12.2025; të Vendimit të Rektoratit Nr.4, datë 02.02.2026 pika 4; referuar shkresës Nr. 576 prot., datë 02.03.2026 të Fakultetit të Edukimit, si dhe referuar Vendimit të Rektoratit Nr. 5, datë 18.03.2026 pika 3, në mbledhjen e datës 30.03.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Projekt - Strategjisë së Profilizimit të Fakultetit të Edukimit, përmes ndërkombëtarizimit për periudhën 2025-2030, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtorët e Drejtorive
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I EDUKIMIT


**PROJEKT- STRATEGJIA E PROFILIZIMIT
TË FAKULTETIT TË EDUKIMIT PËRMES
NDËRKOMBËTARIZIMIT
2025 – 2030**

Durrës, Shkurt 2026



QËLLIMI I PARË I STRATEGJISË: Ndryshimi i qëndrueshëm i FE nëpërmjet integritit në Smart Campusin digjital dhe përdorimit të AI

- ◆ Rritja e mundësive për automatizimi i shërbimeve akademike dhe administrative
- ◆ Rritja e përdorimit të inteligjencës artificiale (AI)
- ◆ Shtimi i numrit të auditorëve smart për performancë



QËLLIMI I DYTË I STRATEGJISË: Ndërkombëtarizimi i arsimit dhe kërkimit shkencor në FE

- ◆ Rritja e numrit të partneriteteve me universitete europiane
- ◆ Zhvillimi i programeve të përbashkëta Master/Doktoraturë
- ◆ Angazhimi në projekte si Horizon Europe dhe Erasmus+
- ◆ Tërheqja e stafit akademik dhe studentëve ndërkombëtarë



QËLLIMI I TRETË I STRATEGJISË: Fakulteti i Edukimit si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të qytetit dhe rajonit të Durrësit

- ◆ Bashkëpunimi me Bashkinë dhe sektorin privat për projekte urbane
- ◆ Përfshirja aktive në transformimin socio-edukativ të Durrësit

Lista e Shkurtimeve

AKKSHI	Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin
AKAFPK	Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë
AKR	Agjencia Kombëtare për Rininë
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
BE	Bashkimi Evropian
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
KiE	Këshilli i Evropës
KM	Këshilli i Ministrave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
RASH	Rrjeti Akademik Shqiptar
RYCO	Regional Youth Cooperation Office (Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor)
SKR	Strategjia Kombëtare e Rinisë
TIK	Teknologjia e informacionit
UAMD	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Pasqyra e lëndës

1. Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik

- 1.1. Lidhja e Strategjisë së Zhvillimit të UAMD me Misionin, Vlerat dhe Prioritetet Institucionale
- 1.2. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Kuadrot Strategjike Ndërkombëtare për Arsimin dhe Kërkimin Shkencor
 - 1.2.1. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs – Agenda 2030, OKB)
 - 1.2.2. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Strategjia e OKB-së për Rininë – “Youth 2030”
 - 1.2.3. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Strategjia Evropiane për Rininë 2019–2027
 - 1.2.4. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë (EHEA) – Procesi i Bolonjës
 - 1.2.5. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Horizon Europe 2021–2027
 - 1.2.6. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Barazinë Gjinore si Prioritet Strategjik në UAMD

2. Profilizimi i UAMD-së në kuadër të ndërkombëtarizimit

- 2.1. Gjendja aktuale dhe profili i FE në UAMD
- 2.2. Target SMART 2025 – 2030 për FE
- 2.3. Riorganizimi i programeve ekzistuese (Audit + reformim kurrikule)
- 2.4. Mekanizmat e ndërkombëtarizimit në FE
- 2.5. Roli i akreditimit në strategjinë e zhvillimit të FE-së
- 2.6. KPI për FE (2025 – 2030) të lidhura me UAMD
- 2.7. Profilizimi i FE-së

3. Ruajtja e qëndrueshmërisë së FE-së

- 3.1. Metodologjia e hartimit të strategjisë në nivel Fakulteti
- 3.2. Analiza SWOT për ruajtjen e qëndrueshmërisë së FE
- 3.3. Deklarata e Vizionit të FE
- 3.4. Shtyllat strategjike të FE
- 3.5. Ruajtja e qëndrueshmërisë së FE-së në rrjetin e universiteteve shqiptare dhe rritja përmes bashkëpunimit ndërkombëtar

4. Përfshirja e studentëve në jetën universitare kulturore, sportive, dhe kërkimore shkencore

- 4.1. Qëllimi Strategjik
- 4.2. Objektivat Specifikë
- 4.3. Nisma të propozuara
- 4.4. Indikatorë të matshëm (KPI)

5. Ruajtja dhe zhvillimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me shkollat e mesme dhe

komunitetin

- 5.1. Qëllimi Strategjik
- 5.2. Objektivat Specifikë
- 5.3. Nisma të propozuara
- 5.4. Indikatorë të matshëm (KPI)

6. Kërkimi shkencor

- 6.1. Roli i kërkimit shkencor në profilizimin dhe ndërkombëtarizimin e FE
- 6.2. Vizioni dhe misioni i kërkimit shkencor në FE
- 6.3. Objektivat strategjike 2025 – 2030 për kërkimin në FE
- 6.4. Mekanizmat kryesor të zbatimit në FE
- 6.5. KPI të matshme për FE
- 6.6. Fazat e zbatimit (të harmonizuara me UAMD)
- 6.7. Monitorimi dhe rezultatet e pritshme

7. Përfshirja e FE-së në projekte kërkimore – shkencore

- 7.1. Strategjia dhe Vizioni
- 7.2. Përfshirja në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare
- 7.3. Ndikimi i projekteve në zhvillimin e fakultetit
- 7.4. Treguesit e suksesit (KPIs)
- 7.5. Fazat e zbatimit

8. Rrjetëzimi Akademik dhe potenciali gjeografik i FE

- 8.1. Strategjia dhe Vizioni
- 8.2. Aktivitete të Sugjeruara në nivel fakulteti
- 8.3. Treguesit e suksesit (KPIs)

9. Bashkëpunimi me Diasporën

- 9.1. Strategjia dhe Vizioni në nivel fakulteti
- 9.2. Integrimi në rrjetet e diasporës akademike dhe kulturore
- 9.3. Bashkëpunimi me QSPA

10. Integrimi i Praktikave Profesionale në kurrikulat e programeve të FE-së dhe Internship-i studentor

- 10.1. Qëllimi Strategjik
- 10.2. Vizioni
- 10.3. Objektivat Strategjike
- 10.4. Implementimi
- 10.5. Monitorimi dhe Vlerësimi
- 10.6. Rezultatet e pritshme për FE

11. Zhvillimi i Masterplanit për një kampus bashkëkohor dhe modern

- 11.1. Vizioni
- 11.2. Misioni

- 11.3. Objektivat Strategjike
- 11.4. Monitorimi dhe vlerësimi
- 11.5. Impaktet kryesorë strategjike

12. Plani për Digjitalizimin

- 12.1. Çfarë duhet për të ardhmen
- 12.2. Digjitalizimi i integruar akademik dhe kërkimor- shkencor

13. Zhvillimi i FE-së në harmoni me strategjinë e zhvillimit të qytetit, rajonit dhe më gjerë

- 13.1. Lidhja me Strategjitë Kombëtare dhe Evropiane
- 13.2. Strategjitë dhe Objektivat Evropiane
- 13.3. Roli i fakultetit në zhvillimin e qytetit të Durrësit
- 13.4. Dimensioni kombëtar dhe më gjerë
- 13.5. Qëllimet Strategjike të FE deri në vitin 2040

1. Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Fakulteti i Edukimit, si një nga njësitë kryesore akademike të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, e sheh zhvillimin e arsimit dhe formimin e mësuesve si një përgjegjësi strategjike me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit. Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UAMD-së për periudhën 2025–2030, Fakulteti synon të konsolidojë profilin e tij akademik përmes ndërkombëtarizimit, duke u pozicionuar si një qendër referimi në fushën e edukimit, kërkimit pedagogjik, social dhe kulturor, si dhe inovacionit arsimor në nivel rajonal dhe më gjerë, me fokus të veçantë tek të rinjtë dhe përgatitja e tyre për tregun e punës dhe jetën aktive qytetare.

Ky dokument strategjik ka për qëllim të përcaktojë drejtimet kryesore të profilizimit të Fakultetit të Edukimit përmes ndërkombëtarizimit, duke integruar dimensionin ndërkombëtar në mësimdhënie, kërkim shkencor, zhvillim institucional dhe shërbim ndaj komunitetit. Ai mbështetet në një qasje gjithëpërfshirëse që synon bashkëpunim të strukturuar me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, por jo vetëm, me institucionet arsimore parauniversitare, pushtetin vendor, partnerë ndërkombëtarë, universitete homologe, si dhe organizata ndërkombëtare që operojnë në fushën e edukimit.

Duke konsideruar si tepër të rëndësishme rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe përgatitjen më të mirë të studentëve për sfidat e së ardhmes, Fakulteti i Edukimit synon dhe përfshirjen aktive të studentëve në procese akademike, kërkimore dhe sociale.

Fokusi strategjik përfshin:

- Internacionalizimin gradual të kurrikulave dhe harmonizimin e tyre me standardet evropiane të formimit të mësuesve dhe profesionistëve të tjerë që përgatit ky fakultet;
- Zgjerimin e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve;
- Zhvillimin e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare kërkimore dhe aplikative;
- Rritjen e publikimeve në revista ndërkombëtare me faktor impakti;
- Organizimin e aktiviteteve akademike ndërkombëtare (konferenca, seminare, shkolla verore, etj).

Strategjia e Fakultetit është në përputhje të plotë me prioritetet e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, Strategjinë Evropiane për Rininë 2019–2027, si dhe me kuadrin ligjor kombëtar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, përfshirë Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ajo gjithashtu harmonizohet me dokumentet strategjike të zhvillimit rajonal dhe me prioritetet e vetë universitetit në fushën e ndërkombëtarizimit.

Procesi i hartimit të strategjisë ka kaluar përmes një sërë konsultimesh me stafin akademik dhe administrativ të universitetit, përfaqësues të studentëve, alumni-t, si dhe partnerë të rëndësishëm nga pushteti vendor dhe partnerë ndërkombëtarë. Këto takime dhe sesione dëgjimore kanë ndihmuar në identifikimin e nevojave reale, pritshmërive dhe sfidave që ndikojnë në zhvillimin institucional të UAMD-së.

Fakulteti i Edukimit angazhohet për të promovuar një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ndaj ndërkombëtarizimit, duke garantuar mundësi të barabarta për studentët dhe stafin, duke forcuar përfshirjen sociale, ndryshimin gradual të praktikave mësimore dhe

kërkimore drejt digjitalizimit, si dhe zhvillimin e kompetencave sociale dhe ndërkulturore. Përmes kësaj strategjie, Fakulteti synon të forcojë rolin e tij si aktor kyç në përgatitjen e profesionistëve të aftë për të vepruar në një kontekst global dhe për të kontribuar në modernizimin e sistemit arsimor dhe atë të shërbimeve në Shqipëri.

Strategjia ka një qasje të qartë për përfshirjen aktive të të rinjve, duke mbështetur mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe duke promovuar përfshirjen sociale, digjitalizimin, praktikat profesionale dhe pjesëmarrjen qytetare.

1.1. Lidhja e Strategjisë së Zhvillimit të FE me Misionin, Vlerat dhe Prioritetet Institucionale

Fakulteti i Edukimit përbën një njësi akademike strategjike brenda Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, me një rol të drejtpërdrejtë në formimin e profesionistëve të arsimit dhe në zhvillimin e kapitalit njerëzor të vendit. I themeluar mbi misionin për të ofruar një arsim cilësor, bashkëkohor dhe të orientuar drejt nevojave të sistemit arsimor shqiptar dhe evropian, Fakulteti synon të konsolidojë profilin e tij si një qendër ekselence në formimin fillestar dhe të vazhduar të mësuesve, si dhe në kërkimin shkencor në fushën e edukimit.

Në përputhje me misionin e universitetit për të qenë një institucion i angazhuar, ndërkombëtar dhe socialisht i përgjegjshëm, Fakulteti i Edukimit angazhohet të zhvillohet si një njësi akademike me orientim të qartë ndërkombëtar, duke integruar standardet evropiane në kurrikula, kërkim dhe praktika pedagogjike.

Oferta akademike e Fakultetit përfshin programe studimi në ciklet bachelor dhe master në fushën e edukimit dhe shkencave sociale të lidhura me formimin e mësuesve. Këto programe synojnë përgatitjen e profesionistëve të aftë për të operuar në një sistem arsimor në transformim të vazhdueshëm, të ndikuar nga digjitalizimi, globalizimi dhe zhvillimet teknologjike. Profilizimi i Fakultetit do të mbështetet në:

- ndërkombëtarizimin e formimit të mësuesve;
- integrimin e kompetencave digjitale dhe ndërkulturore;
- zhvillimin e kërkimit pedagogjik me dimension krahasues dhe evropian.

Fakulteti karakterizohet nga një staf akademik i kualifikuar dhe i përkushtuar, i cili kontribuon jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në zhvillimin e kërkimit shkencor në edukim, inovacionin pedagogjik dhe bashkëpunimin me institucionet arsimore parauniversitare. Në kuadër të profilizimit përmes ndërkombëtarizimit, prioritet do të jetë rritja e pjesëmarrjes së stafit në projekte ndërkombëtare, publikime në revista të indeksuara dhe rrjete akademike evropiane.

Duke operuar në një mjedis arsimor gjithnjë e më të ndërlidhur globalisht, Fakulteti i Edukimit synon të forcojë rolin e tij si një qendër moderne dhe inovative, që promovon përfshirjen sociale, barazinë e mundësive dhe zhvillimin e kompetencave për qytetari aktive në një kontekst evropian. Përmes ndërkombëtarizimit, Fakulteti do të:

- rrisë mobilitetin e studentëve dhe stafit;
- zhvillojë partneritete strategjike me fakultete homologe në Evropë dhe rajon;
- ofrojë lëndë dhe module në gjuhë të huaj;
- ofrojë kurse dhe trajnim për studentët e huaj;

- krijojë mundësi për programe të përbashkëta dhe diploma të dyfishta në afatmesëm.

Synimet afatgjata të Fakultetit janë të konsolidojë pozicionin e tij si një njësi akademike lider në fushën e edukimit në nivel rajonal, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së sistemit arsimor shqiptar. Strategjia e zhvillimit të Fakultetit do të mbështetet në:

- rritjen e cilësisë akademike në formimin e mësuesve;
- forcimin e lidhjeve me shkollat dhe institucionet arsimore;
- promovimin e kërkimit inovativ në edukim;
- zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare;
- adoptimin e teknologjive digjitale dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies.

Një prioritet i veçantë do të jetë profilizimi ndërkombëtar i programeve të studimit, përmes harmonizimit me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, integritet të praktikave më të mira evropiane dhe përfshirjes në rrjete ndërkombëtare të formimit të mësuesve. Fakulteti synon të rrisë numrin e studentëve të huaj në programe të caktuara, të organizojë aktivitete akademike ndërkombëtare dhe të forcojë dimensionin kërkimor përmes projekteve të financuara nga programe evropiane.

Në këtë kuadër, Fakulteti i Edukimit do të zhvillohet në harmoni me prioritetet lokale dhe rajonale në fushën e arsimit, duke kontribuar në zhvillimin e qytetit dhe rajonit përmes ekspertizës akademike, trajnimeve profesionale dhe projekteve me ndikim social. Digjitalizimi i proceseve mësimore, përdorimi i platformave ndërkombëtare të bashkëpunimit dhe krijimi i laboratorëve pedagogjikë bashkëkohorë do të përbëjnë elementë kyç të këtij transformimi.

Objektivi final është që Fakulteti i Edukimit të njihet si një njësi akademike moderne, ndërkombëtare dhe e qëndrueshme, e orientuar drejt zhvillimit të inovacionit arsimor dhe përmirësimit të cilësisë së arsimit në Shqipëri dhe më gjerë.

1.2. Lidhja e Strategjisë së FE-së me Kuadrin Strategjik Ndërkombëtar për Arsimin dhe Kërkimin Shkencor

Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Edukimit për periudhën 2025–2030 ndërtohet në përputhje të plotë me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arsimit, kërkimit pedagogjik dhe formimit të mësuesve, duke reflektuar orientimin strategjik të Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës drejt ndërkombëtarizimit, inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Fakulteti synon të konsolidojë profilin e tij akademik përmes integritet të dimensionit ndërkombëtar në kurrikula, kërkim shkencor dhe bashkëpunime institucionale, duke respektuar drejtimit strategjike të institucioneve evropiane dhe globale që udhëheqin zhvillimin e arsimit dhe kërkimit në fushën e edukimit.

Kjo përputhje konkretizohet përmes lidhjeve të mëposhtme:

1.2.1. Lidhja e Strategjisë së FE-së me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs – Agenda 2030, OKB)

Në përputhje me Agjendën Globale 2030, Fakulteti i Edukimit kontribuon drejtpërdrejt në disa prej objektivave kryesore:

SDG 4 – Arsimi cilësor: Formimi i mësuesve, kujdestarëve dhe edukatorëve të kualifikuar, zhvillimi i kurrikulave bashkëkohore dhe promovimi i praktikave pedagogjike gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në evidencë shkencore.

SDG 5 – Barazia gjinore: Integrimi i perspektivës gjinore në programet e studimit, kërkimin shkencor dhe praktikat institucionale, si dhe promovimi i rolit të grave në arsim dhe udhëheqje akademike.

SDG 8 – Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike: Përgatitja e profesionistëve të arsimit dhe jo vetëm, të aftë për tregun e punës, përmes praktikave profesionale, bashkëpunimit me shkollat dhe zhvillimit të kompetencave për jetën dhe punën në epokën digjitale.

SDG 9 – Inovacion dhe infrastrukturë: Zhvillimi i laboratorëve pedagogjikë, përdorimi i teknologjive digjitale në mësimdhënie dhe kërkim, si dhe integrimi i metodave inovative në formimin e mësuesve, kujdestarëve dhe edukatorëve.

SDG 13 – Veprim për klimën: Promovimi i edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe përfshirja e tematikave mjedisore në kurrikula dhe projekte kërkimore.

SDG 16 – Institucione të forta dhe përfshirëse: Forcimi i kulturës së transparencës, etikës akademike dhe pjesëmarrjes studentore në vendimmarrje.

SDG 17 – Partneritete për qëllimet: Zhvillimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare me fakultete homologe, rrjete akademike dhe institucione arsimore evropiane.

1.2.2. Lidhja e Strategjisë së FE-së me Strategjia e OKB-së për Rininë – “Youth 2030”

Duke e konsideruar Fakultetin e Edukimit si një hapësirë kyçe për formimin e brezave të rinj të mësuesve dhe profesionistëve të edukimit, strategjia synon të sigurojë:

- mundësi të barabarta për zhvillim akademik dhe profesional;
- pjesëmarrje aktive të studentëve në projekte kërkimore dhe iniciativa ndërkombëtare;
- zhvillimin e kompetencave ndërkulturore dhe digjitale.

Në këtë kuadër, Strategjia synon të promovojë të rinjtë si aktorë të zhvillimit dhe kontribues në zbatimin e OZHQ-ve, në përputhje me parimet e strategjisë globale të OKB-së për rininë.

1.2.3. Lidhja e Strategjisë së FE-së me Strategjia Evropiane për Rininë 2019–2027

FE

mbështet parimet e kësaj strategjie përmes

- promovimin e mobilitetit të studentëve dhe stafit përmes programeve si Erasmus+;
- zhvillimin e moduleve me përmbajtje ndërkombëtare dhe literaturë bashkëkohore;
- përfshirjen e studentëve në aktivitete akademike me dimension evropian;
- nxitjen e inovacionit pedagogjik dhe sipërmarrjes sociale në arsim.

1.2.4. Lidhja e Strategjisë së FE-së me Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë (EHEA) – Procesi i Bolonjës

Strategjia e Fakultetit mbështetet në:

- sistemin e kreditimit ECTS
- harmonizimin me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve;
- forcimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane;
- sigurimi i cilësisë akademike përmes AKKSHI
- promovimin e diplomave të njohura ndërkombëtarisht;
- rritjen e mobilitetit të stafit dhe studentëve si tregues i ndërkombëtarizimit real.

1.2.5. Lidhja e Strategjisë së FE-së me Horizon Europe 2021–2027

Si pjesë e profilizimit përmes ndërkombëtarizimit, Fakulteti synon:

- rritjen e kapaciteteve për aplikime në programet e kërkimit të Bashkimit Evropian;
- ndërtimin e rrjeteve ndërkombëtare kërkimore në fushën e edukimit;
- përfshirjen e stafit dhe studentëve në projekte që adresojnë sfida bashkëkohore të arsimit (digjitalizimi, barazia, mirëqenia në shkollë, inovacioni pedagogjik) dhe zgjidhje të qëndrueshme;
- rritjen e publikimeve në revista të indeksuara ndërkombëtarisht.

1.2.6. Lidhja e Strategjisë së FE-së me Barazinë Gjinore si Prioritet Strategjik në UAMD

Në përputhje me dokumentet kombëtare dhe evropiane për barazinë gjinore, Fakulteti i Edukimit e konsideron integrimin gjinor si parim themelor të zhvillimit institucional.

Në nivel fakulteti, masat synojnë:

- garantimin e mundësive të barabarta për studentë dhe staf nga të gjitha grupet shoqërore;
- përfaqësim të barabartë në strukturat vendimmarrëse dhe projektet kërkimore;
- parandalimin e çdo forme diskriminimi dhe dhune me bazë gjinore;
- integrimin e perspektivës gjinore në kurrikula dhe kërkim shkencor;
- krijimin e një ambienti akademik të sigurt dhe gjithëpërfshirës.

Përmes kësaj qasjeje, Fakulteti i Edukimit synon të konsolidojë një kulturë institucionale që promovon drejtësinë sociale, barazinë dhe respektin, duke përgatitur profesionistë të arsimit që reflektojnë këto vlera në praktikën e tyre pedagogjike.

II. Profilizimi i UAMD-së në kuadër të ndërkombëtarizimit

2.1 Gjendja aktuale dhe profili i FE në UAMD

Fakulteti i Edukimit është një nga shtyllat kryesore të UAMD-së, me rol qendror në përgatitjen e mësuesve dhe profesionistëve të fushave humaniste e sociale (gjuhë, letërsi, pedagogji, sociologji, psikologji, gjuhë të huaja, gerontologji, kujdestari, edukim në vazhdim). Aktualisht, ndërkombëtarizimi në UAMD është ende i përqendruar kryesisht në programe double degree të cilat ofrohen në gjuhën shqipe dhe dy ose tre lëndë në gjuhë të huaj, ndërsa për FE ndërkombëtarizimi duhet të shtrihet në mënyrë të strukturuar: përmes programeve në gjuhë të huaj, moduleve në anglisht, partneriteteve Joint/Double, mikrokrediteve dhe mobilitetit.

Pozicionimi strategjik i FE në kuadër të ndërkombëtarizimit:

- FE si “hub” për mësimdhënie moderne, pedagogji digjitale, psikologji edukimi, gjuhë dhe kulturë, me orientim drejt standardeve evropiane (ECTS, cilësi, mobilitet).
- FE si “qendër shërbimi” për universitetin dhe komunitetin: trajnime të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave, përgatitje profesionistësh të përkujdesit, trajnime të stafit, kurse gjuhe të huaja dhe gjuhë shqipe, mikrokredite për mësues, module ndërkulturore dhe metodologji kërkimore.

2.2. Target SMART 2025–2030 për FE

Duke u bazuar te targeti i UAMD: “50% programe me $\geq 20\%$ mësim në anglisht dhe marrëveshje bashkë-diplomimi/dual deri 2030”, FE e përkthen në objektiva të matshëm:

SMART 1 (Programe / Module):

Deri në 2027, FE të ketë të paktën 1 program të ofruar në gjuhë të huaj (ose program i ri, ose track/variant në anglisht brenda një programi ekzistues).

Deri në 2030, minimumi 50% e programeve të FE të kenë $\geq 20\%$ lëndë/module në anglisht (ose të ofertohej si “Foreign languages-taught modules” për studentë incoming).

SMART 2 (Partneritete Joint/Double):

Deri në 2027, FE të ketë 5 marrëveshje Joint/Double Degree (Bachelor ose Master) me universitetet partnere.

Deri në 2030, FE të ketë të paktën 8 programe Joint/Double/(Bachelor Master ose PhD).

SMART 3 (Mikrokredite & Edukim në Vazhdim):

Deri në 2028, të zhvillohen 4 module me mikrokredite në temat: pedagogji digjitale, vlerësim & rubrika, menaxhim klase hibride, etikë akademike & AI në edukim. Deri në 2030, të ofrohen 12+ module me mikrokredite dhe të jenë të transferueshme drejt Master/Bachelor (në përputhje me modelin e UAMD për lifelong learning).

SMART 4 (Studentë & Mobilitet):

Deri në 2030, FE të arrijë 10% studentë ndërkombëtarë (nga shkëmbime semestrale, programe të përbashkëta, summer schools, blended modules).

2.3. Riorganizimi i programeve ekzistuese (Audit + Reformim kurrikule)

Në përputhje me strategjinë e UAMD, FE- realizon riorganizimin në 3 hapa:

2.3.1 Audit viti akademik (2025–2026)

- Analizë e programeve aktuale të FE me fokus: përputhje me programe të ngjashme në universitete evropiane, rezultatet e të nxënësve (learning outcomes), praktikën profesionale, komponentin e kërkimit.
- Identifikim i lëndëve me literaturë ndërkombëtare të pasur dhe interes për studentë të huaj:
p.sh. English, Educational Psychology, Inclusive Education, Research Methods, Classroom Management, Intercultural Communication, Digital Pedagogy, Assessment & Evaluation, Child Development, Counseling Basics.

2.3.2 Reformim kurrikule (2026–2030)

- Shtim i moduleve në anglisht (fillimisht 2–3 lëndë në çdo program si pilot).
- Futje e moduleve ndërkulturore: “Intercultural Communication in Education”, “Global Citizenship Education”, “Comparative Education”.
- Integrim i moduleve teknologjike & ndërdisiplinore: “AI in Education”, “Learning Analytics Basics”, “Digital Assessment”, “Educational Data Literacy”.
- Përgatitje e stafit për mësimdhënie në anglisht: kurse të gjuhës akademike + co-teaching me profesorë të huaj (online/blended).

2.4. Mekanizmat e ndërkombëtarizimit në FE

2.4.1 Joint & Double Degrees (qasje graduale)

- Pilot 1 program test (2026–2030), p.sh. Master: “Inclusive Education/Digital Pedagogy” ose tjetër me partner evropian.
- Standardizim i modelit të marrëveshjeve: përafrim kurrikulash, njohje kreditesh ECTS, rregulla mobiliteti, standarde të vlerësimit.
- Krijim i Komisionit Ad Hoc FE për Joint/Double: monitorim, koordinim, procedura administrative, cilësi.

2.4.2 Kurrikulë fleksibël dhe modulare

- Ristrukturim i programeve në **module standarde me ECTS** (core + elective).
- Hapje e moduleve të FE për studentë nga fakultete të tjera dhe për studentë incoming.
- Paketim i “minor tracks” (p.sh. *Digital Pedagogy Minor*, *Inclusive Education Minor*).
- Platformë digjitale për zgjedhje moduli + monitorim progresi (në linjë me “Digital Campus”).

2.4.3 Mobilitet virtual dhe projekte të përbashkëta online

- COIL (Collaborative Online International Learning): projekte online me universitete partnere në lëndë të FE.

Javë ndërkulturore, leksione të hapura, workshope metodologjike kërkimi me ekspertë të huaj.

2.5. Roli i Akreditimit në Strategjinë e Zhvillimit të FE-së

Përfshirja e akreditimit si komponent strategjik synon të sigurojë që FE jo vetëm të përmbushë detyrimet ligjore dhe standartet kombëtare, por të ndërtojë një kulturë të

brendshme të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Objektivi kryesor është që të gjitha programet e studimit të ndjekin ciklin ligjor të vlerësimit dhe akreditimit në përputhshmëri me Standartet e Cilësisë së Arsimit të Lartë në Shqipëri.

a. Garanci për Cilësinë Akademike

Akreditimi siguron që programet e studimit përmbushin standardet kombëtare të cilësisë, duke krijuar bazën ligjore dhe institucionale për vlerësim të jashtëm dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Procesi i akreditimit nxit zhvillimin dhe rishikimin periodik të kurrikulave, forcimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe rritjen e kapaciteteve kërkimore, në përputhje me kërkesat e raporteve të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm.

b. Ndërkombëtarizimi dhe Sigurimi i Cilësisë

Programet me diploma të përbashkëta, të dyfishta apo shumëfishe duhet të sigurojnë përputhshmërinë me parimet e ESG-së dhe standardet që kërkohen nga partnerët ndërkombëtarë. Akreditimi kombëtar, si proces i detyrueshëm ligjor, garanton besueshmëri institucionale në marrëveshjet ndërkombëtare.

c. Transparencë dhe Besueshmëri për Studentët dhe Partnerët

Akreditimi institucional dhe i programeve rrit transparencën ndaj studentëve dhe garanton cilësinë e diplomave të lëshuara, duke krijuar siguri në tregun e punës dhe në institucionet akademike brenda dhe jashtë vendit.

Masat Strategjike për Akreditimin në kuadër të Planit afatgjatë 2030-2040

Qëllimi	Veprimet kryesore
Rritja e numrit të programeve të akredituara	- Proces i vetëvlerësimit të brendshëm të programeve për akreditim. - Hartimi dhe rishikimi i kurrikulave në përputhje me standardet kombëtare, duke u orientuar nga parimet e ESG për sigurimin e cilësisë. - Organizimi i trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ mbi menaxhimin e cilësisë dhe proceset e akreditimit
Integrimi i procesit të akreditimit në planifikimin akademik të FE	- Akreditimi mbetet mekanizëm i detyrueshëm i sigurimit të cilësisë, i cili zbatohet për të gjitha programet e studimit, në përputhje me fazën e zhvillimit të programit dhe afatet ligjore. - Krijimi i një kalendari të brendshëm për rivlerësime periodike të programeve.
Zhvillimi i programeve ndërkombëtare dhe sigurimi i cilësisë së tyre	- Bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë për vlerësimin dhe, kur është e nevojshme, akreditimin e përbashkët të programeve të dyfishta/shumëfishe. - Përdorimi i ekspertizës ndërkombëtare për hartimin dhe harmonizimin e dokumentacionit. - Vlerësimi rast pas rasti i nevojës për akreditim ndërkombëtar në funksion të objektivave strategjike

2.6. KPI për FE (2025–2030) – të lidhura me UAMD

KPI kryesorë:

- % e programeve të FE me $\geq 20\%$ module në anglisht (target 50% deri 2030)
- programe në gjuhë të huaj (minimum 1 deri 2027)
- marrëveshje Joint/Double (8 deri 2030)
- mikrokredite të ofruara (12+ deri 2030)
- staf i trajnuar për gjuhë akademike dhe pedagogji digjitale (target 60% deri 2030)
- studentë incoming/outgoing + mobilitet virtual (rritje vjetore e matshme)
- module ndërkulturore/ndërdisciplinore të integruara (rritje progresive)

2.7. Profilizimi i FE-së

Fakulteti i Edukimit është ndër më të rëndësishmit, me një rol të madh në përgatitjen e mësuesve dhe profesionistëve të fushave humaniste e sociale. *Departamenti i Gjuhës Shqipe* ka si fokus studimin e gjuhës shqipe, gjuhësisë teorike dhe didaktikës së saj. *Departamenti i Letërsisë* mbulon fushën e studimeve letrare shqiptare dhe botërore, duke i ofruar studentëve njohuri mbi teorinë dhe kritikën letrare dhe jo vetëm. *Departamenti i Gjuhëve të Huaja* përfshin mësimin e gjuhëve si anglishtja dhe gjermanishtja dhe përgatitjen e profesionistëve që bazohen tek këto gjuhë. *Departamenti i Pedagogjisë* merret me përgatitjen e mësuesve dhe zhvillimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies. *Departamenti i Sociologjisë* trajton strukturat shoqërore dhe dinamika të ndryshme të jetës sociale. *Departamenti i Psikologjisë* mbulon fushën e psikologjisë së përgjithshme, edukimit dhe këshillimit. *Qendra për Edukim në Vazhdim* shërben si qendër për formimin e profesionistëve të shërbimeve për të moshuar dhe fëmijë 0-3 vjeç, qendër trajnimi për mësues dhe profesionistë në shërbim të zhvillimit profesional të vazhdueshëm.

FE synon që deri në vitin 2030 të forcojë profilin e tij ndërkombëtar duke zhvilluar programe të përbashkëta, diploma të dyfishta dhe module të ofruara në gjuhë të huaja. Strategjia pesëvjeçare 2025–2030 fokusohet te konsolidimi i departamenteve sipas fushave të tyre dhe orientimi drejt një vizioni të qartë të ndërkombëtarizimit, duke integruar njëkohësisht përdorimin e inteligjencës artificiale, mësimin online dhe teknologjive moderne të mësimdhënies, në përputhje me drejtimet e Bashkimit European për arsimin digjital. Ky vizion afatgjatë përfshin tri faza kryesore: konsolidimin (2025–2030), zgjerimin (2030–2035) dhe inovacionin e integruar (2035–2040). *Fakulteti i Edukimit* do të mbetet bërthama e formimit shoqëror, por i orientuar më fort drejt kompetencave digjitale, për të formësuar qytetarë aktiv dhe të aftë për të përballuar nevojat dhe kërkesat e një shoqërie që zhvillohet.

III. Ruajtja e qëndrueshmërisë së FE-së dhe rritja nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar

Strategjia e Fakultetit të Edukimit është mbështetur në premisën se formimi i mësuesve dhe profesionistëve të edukimit kërkon përshtatje të vazhdueshme ndaj zhvillimeve pedagogjike, teknologjike, sociale e bashkëkohore në perspektivë. Në një klimë konkurruese kombëtare

dhe ndërkombëtare, Fakulteti synon të luajë rolin e një qendre rajonale cilësore në shkencat e edukimit, duke forcuar partneritetet aktuale me institucione të huaja të arsimit të lartë, duke krijuar bashkëpunime të reja me institucione të ngjashme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, organizata ndërkombëtare me prirje akademike dhe shkencore, si dhe duke krijuar rrjete akademike në fushën e mësuesisë dhe kërkimit shkencor.

Krijimi i një mjedisi akademik gjithëpërfshirës, ku studentët të ndihen bashkëkrijues të procesit mësimor, praktikës profesionale dhe kërkimit shkencor, përbën një shtyllë themelore të zhvillimit të Fakultetit. Forcimi i lidhjeve me shkollat dhe komunitetin lokal është pjesë integrale e vizionit për të dhënë kontributin e duhur për përmirësimin e cilësisë së arsimit në Shqipëri dhe për zhvillimin socio-kulturor të qytetit, të rajonit e më gjerë.

3.1 Metodologjia e hartimit të strategjisë në nivel fakulteti

Për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit të Edukimit për periudhën 2025–2030, në përputhje me orientimet institucionale të universitetit, është ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, e bazuar në analizën e detajuar të strategjisë së UAMD dhe përshtatjes së saj me kushtet e FE duke synuar rritjen progresive të Fakultetit në drejtim të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe procesit të ndërkombëtarizimit.

Procesi hartimit të strategjisë është bazuar në punën dhe analizën e grupit të punës ngritur me Urdhër Dekani, për zbatimin e strategjisë së UAMD, në ekspertizën dhe profesionalizmin e anëtarëve të grupit me përfaqësi nga çdo departament i Fakultetit të Edukimit, si dhe në përdorimit të instrumenteve analitike dhe përkthimit në objektiva strategjike.

3.2. Analiza *SWOT* për ruajtjen e qëndrueshmërisë së Fakultetit të Edukimit

Në vijim të strategjisë së zhvillimit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë akademike, institucionale dhe financiare për Fakultetin e Edukimit është realizuar analiza SWOT, me qëllim identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në performancën dhe perspektivën e tij zhvillimore për të ardhmen, si një ndër fakultetet e UAMD-së me vizion, potencial dhe prioritete të qarta për të ardhmen.

Pikat e Forta

- Krijimi i një tradite me standarde të larta shkencore në fushën e mësimdhënies dhe i një përvoje të suksesshme në formimin bazë dhe të vazhdueshëm të mësuesve, dhe të profesionistëve të tjerë në fushën e shërbimeve.
- Të paturit e një stafi akademik të kualifikuar me titujt e grada shkencore si dhe me formim shkencor e didaktik në përputhje me kërkesat bashkëkohore në fushat kyçe të edukimit.
- Bashkëpunime me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe ofrimi i programeve të dyfishta të studimit në nivelin e dytë dhe të tretë të studimeve.
- Bashkëpunim i konsoliduar me institucione të arsimit parauniversitar për zhvillimin e suksesshëm e cilësor praktikave profesionale.
- Përshtatje e programeve të studimit me nevojat e sistemit arsimor kombëtar.

- Mbështetje institucionale për procesin e ndërkombëtarizimit dhe të zhvillimit të projekteve akademike e shkencore.
- Përfshirje e studentëve në aktivitete me karakter kërkimor, shkencor, kulturor dhe social.

Dobësitë

- Infrastrukturë e pamjaftueshme për kërkime empirike dhe laboratorë didaktikë si dhe laboratorë shërbimesh.
Nivele jo shumë të kënaqshme për përfshirje të studentëve në kërkimin shkencor.
- Mugesë në infrastrukturën digjitale bashkëkohore
- Përfshirje jo e lartë në kërkime shkencore
- Domosdoshmëri për njësi akomoduese për studentët që vijnë nga rrethet dhe nga jashtë vendit.

Mundësitë

- Reformat e vazhdueshme në arsimin parauniversitar që rrisin kërkesën për mësues të kualifikuar si në aspektin teorik, ashtu edhe në aspektin praktik.
- Mundësi financimi për projekte kërkimore dhe zhvillimore në fushën e edukimit nga BE (Erasmus+, Horizon Europe).
- Rritja e interesit për programe studimi në fushën e edukimit nga studentë vendas dhe të huaj.
- Rritje e interesit për programet profesionale në fushën e shërbimeve sociale
- Rritje e interesit për programet e reja në Shkencat Sociale
- Zhvillimi i mësimdhënies digjitale dhe inovacionit pedagogjik.
- Rritje e interesit për programe me diploma të dyfishta
- Startegji për hapjen e programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta me fakultete edukimi në rajon dhe BE.

Kërcënimet:

- Ulja e interesit për profesionin e mësuesit dhe emigrimi i të rinjve.
- Konkurrenca nga universitete të tjera publike dhe private në fushën e edukimit.
- Ndryshime të shpeshta në politikat arsimore dhe ato sociale si dhe kriteret e punësimit të profesionistëve.
- Rreziku i pamundësisë së ndjekjes së zhvillimeve bashkëkohore pedagogjike dhe teknologjike në fushën e edukimit.

3.3 Deklarata e Vizionit të Fakultetit të Edukimit

Vizioni Strategjik i Fakultetit të Edukimit

Në përputhje me misionin dhe orientimin strategjik të Universitetit, Fakulteti i Edukimit synon të jetë një njësi akademike themelore në përgatitjen e profesionistëve të arsimit, shkencave të edukimit dhe shërbimit, me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin cilësor të

sistemit arsimor dhe atij të shërbimeve në nivel kombëtar, por dhe rajonal.

Vizioni i Fakulteti i Edukimit në të ardhmen do të jetë: Një fakultet bashkëkohor, inovativ dhe gjithëpërfshirës, që formon mësues, pedagogë, edukatorë, kujdestarë dhe specialistë të arsimit dhe shërbimeve sociale me formim shkencor cilësor dhe me integritet etik, kompetenca digjitale si dhe aftësi për t'iu përgjigjur sfidave të shoqërisë në shekullin XXI.

Misioni i Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit të Edukimit

Misioni i Strategjisë së Zhvillimit të Fakultetit të Edukimit është të garantojë cilësi të lartë në formimin bazë dhe të vazhdueshëm të mësuesve dhe specialistëve të edukimit dhe shërbimeve mbështetur në zhvillimet shkencore bashkëkohore të vendit dhe të universiteteve në rajon e më gjerë; të zhvillojë më tej kërkimin shkencor në fushën e arsimit, si dhe të japë ndihmesën e tij në përmirësimin e praktikave pedagogjike në sistemin arsimor shqiptar dhe më gjerë.

Fakulteti synon të krijojë një mjedis akademik gjithëpërfshirës, që mbështet zhvillimin shkencor të stafit akademik dhe të studentëve, nxit mendimin kritik, etikën profesionale dhe kulturën e inovacionit në mësimdhënie dhe në fushën e kërkimit shkencor.

Parimet Themelore të Strategjisë së Zhvillimit

Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Edukimit mbështetet në këto parime themelore:

- **Cilësi dhe profesionalizëm në formimin e mësuesve dhe specialistëve të edukimit dhe shërbimeve** përmes programeve të studimit të harmonizuara me standardet kombëtare dhe evropiane.
- **Qasje gjithëpërfshirëse dhe barazi në arsim** duke promovuar edukimin gjithëpërfshirës dhe duke i dhënë vlerën e duhur konceptit "të diversitetit" në të gjitha nivelet e formimit.
- **Integritim i teorisë me praktikën** përmes praktikave profesionale, partneriteteve me institucione arsimore dhe përfshirjes aktive në komunitet.
- **Kërkim shkencor dhe inovacion pedagogjik** me fokus në përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënës në bashkëpunim me zhvillimet metodologjike bashkëkohore.
- **Digjitalizim dhe zhvillim i kompetencave teknologjike** për përgatitjen e profesionistëve për mjedise bashkëkohore dhe hibride të të nxënës, si një kërkesë e të tashmes dhe e së ardhmes më arsim.
- **Monitorim dhe vlerësim i vazhdueshëm** për të garantuar cilësi, transparencë, përgjegjshmëri dhe përmirësim të qëndrueshëm institucional.

Në këtë kuadër, Fakulteti i Edukimit synon të konsolidohet si një institucion universitar bosht në fushën e edukimit për formimin e profesionistëve, duke vendosur në qendër studentin, cilësinë akademike dhe përgjegjësinë profesionale dhe shoqërore.

3.4. Shtyllat Strategjike të Fakultetit të Edukimit

Vizioni i Fakultetit të Edukimit do të realizohet duke u mbështetur në tri shtylla bosht apo strategji të cilat do ta kthejnë këtë fakultet në një institucion kyç të arsimit të lartë dhe në një pikë reference në fushën e edukimit për institucione të së njëjtës natyrë brenda vendit, në rajon, por edhe më gjerë se cilat janë:

- I- Transformimi digjital dhe qëndrueshmëria në formimin profesionistëve
- II- Ndërkombëtarizimi i programeve dhe i kërkimit në edukim
- III- Bashkëpunimi i ngushtë me komunitetin dhe zhvillimi rajonal

Transformimi digjital dhe qëndrueshmëria në formimin e profesionistëve.

Qëllimet:

- Automatizimi i shërbimeve akademike dhe administrative për shtafin akademik dhe studentët.
- Përdorimi i Inteligjencës Artificiale (AI) dhe të internetit të Pajisjeve (IoT) në mësimdhënie dhe menaxhimin institucional.

Objektivat:

- Krijimi i një strukture të digjitalizuar nëpërmjet automatizimit të proceseve administrative (regjistrimi i studentëve on-line, menaxhimi i provimeve, komunikimin me studentët dhe arkivimin digjital).
- Digjitalizimi i materialeve mësimore mësuara në natyrën dhe tipologjinë e lëndëve.
- Përgatitja e studentëve për përdorimin e platformave digjitale, inteligjencës artificiale dhe mjeteve interaktive në fuksion të procesit të të nxënit.
- Promovimi i edukimit për zhvillim të qëndrueshëm teoriko-praktik dhe në progres, mbështetur në përdorimin e mjeteve digjitale.

Ndërkombëtarizimi i programeve dhe i kërkimit në edukim

Qëllimet:

- Politika për rritjen e numrit të partneriteteve strategjike me universitetet evropiane
- Zhvillimi i programeve të përbashkëta në nivelin e dytë dhe të tretë të studimeve
- Përfshirja në projekte të Bashkimit Evropian (Erasmus + dhe Horizon Europe)
- Përfshirja e studentëve të huaj dhe e stafit akademik ndërkombëtar.

Objektivat:

- Krijimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit dhe partneriteteve strategjike me universitete evropiane dhe ndërkombëtare.
- Krijimi i programeve të përbashkëta të studimit prej njësive bazë të fakultetit me universitete partnere evropiane.
- Rrija e numrit të aplikimeve dhe pjesëmarrjes në programe, si: Erasmus + dhe Horizon Europe, por edhe në projekte të tjera brenda vendit, në rajon e më gjerë.
- Publikime shkencore në revista të indeksuara dhe projekte të përbashkëta me partnerë të huaj.
- Rritja e mobilitetit të studentëve dhe stafit në kuadër të programeve ndërkombëtare (Erasmus+, projekte kërkimore etj.)
- Pjesëmarrja aktive në konferenca dhe rrjete kërkimore ndërkombëtare në fushën e edukimit.
- Publikime shkencore në revista të indeksuara dhe projekte të përbashkëta me partnerë të huaj.

Angazhimi me komunitetin dhe zhvillimi rajonal

Qëllimet:

- Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe sistemin arsimor Forcimi i bashkëpunimit me drejtoritë arsimore, shkollat publike dhe private, si dhe organizatat e shoqërisë civile për zhvillimin e projekteve arsimore, sociale dhe komunitare që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies, bashkëpunimin dhe ndikimin e mjedisit universitar të FE-së në komunitet.
- Nxitja e iniciativave studentore në fushën e edukimit Mbështetja e projekteve dhe iniciativave studentore që synojnë inovacionin në mësimdhënie dhe mësimnxënie, krijimi i një qasjeje me zhvillim progresiv në kërkimin shkencor, si dhe përfshirja në edukimin komunitar.
- Përfshirja aktive në transformimin arsimor dhe social të vendit dhe rajonit Angazhimi i Fakultetit të Edukimit në proceset e reformimit dhe përmirësimit të sistemit arsimor universitar përmes një stafi të kualifikuar, studimeve kërkimore-shkencore dhe politikave arsimore të bazuara në matje konkrete.

Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit

Për të siguruar zbatimin efektiv të strategjisë Fakulteti i Edukimit do të zbatojë një plan të rregullt monitorimi dhe vlerësimi i cili do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi ecurinë e çdo veprimtarie dhe indikatorët përkatës (KPI).
- Anketa me studentët, stafin dhe aktorë të jashtëm për të vlerësuar ndikimin.
- Rishikimin e strategjisë çdo dy vite për përshtatje me zhvillimet e reja.
- Përdorimin e një paneli treguesish për krahasime me universitetet homologe.

Ky sistem do të garantojë transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm.

3.5. Ruajtja e qëndrueshmërisë së Fakultetit të Edukimit në rrjetin e universiteteve shqiptare dhe rritja përmes bashkëpunimit ndërkombëtar

Qëllimi Strategjik

Të sigurohet një pozicionim i qëndrueshëm dhe konkurrues i Fakultetit të Edukimit në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të arsimit të lartë, përmes ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, rritjes së mobilitetit akademik dhe zgjerimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e arsimit dhe kërkimit pedagogjik.

Objektivat Specifikë

- Hartimi i politikave për përfshirjen e studentëve ndërkombëtarë në programe të lidhura me edukimin dhe mësuesinë dhe jo vetëm
- Më shumë programe studimi në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht, në nivelet e studimit Bachelor dhe Master.
- Thëllimi i mëtejshëm i partneriteteve ndërkombëtare akademike dhe kërkimore
- Zhvillimi i një infrastrukture akademike dhe administrative mbështetëse për studentët ndërkombëtarë, me qëllim integrimin e tyre të plotë akademik dhe social.

- Ofrimi i kurseve në gjuhën shqipe për studentë të huaj, me fokus në gjuhën dhe kulturën shqiptare, si element integruar dhe promovues i identitetit kombëtar.

Nisma të Propozuara

- Zhvillimi i fushatave promovuese ndërkombëtare të orientuara drejt programeve të edukimit, me fokus vendet e rajonit e më gjerë.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për programe të përbashkëta (double/joint degrees) me universitete partnere strategjike në fushën e edukimit
- Hartimi dhe akreditimi i programeve Bachelor/Master në gjuhën angleze, në fushat themelore që mbulojnë njësitë bazë përbërëse të fakultetit.
- Forcimi i strukturave ekzistuese institucionale për mbështetjen e studentëve ndërkombëtarë, përmes një sistemi të integruar shërbimesh (orientim akademik, mentorim, mbështetje administrative dhe sociale).

Indikatorë të Matshëm (KPI) 2025–2030

- Rritje vjetore e numrit të studentëve ndërkombëtarë të regjistruar në FE
- Programe studimi në gjuhën angleze të akredituara deri në vitin 2030
- Shtim i marrëveshjeve ndërkombëtare
- Përmirësimi i nivelit të rankimeve ndërkombëtare

IV. Përfshirja e studentëve në jetën universitare kulturore, sportive dhe kërkimore shkencore

4.1. Qëllimi Strategjik:

Të zhvillohet një mjedis universitar gjithëpërfshirës, ku studentët angazhohen përtej auditorit, në aktivitete që nxisin kreativitetin, mirëqenien, shprehjen dhe kontributin në komunitet.

4.2. Objektivat specifike:

- Zhvillimi i aktiviteteve të rregullta kulturore dhe artistike;
- Nxitja e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete sportive dhe klube të organizuara;
- Angazhimi i studentëve në projekte kërkimore dhe aplikative.

4.3. Nisma të propozuara:

- Krijimi dhe mbështetja e klubeve studentore (shkencore, kulturore, sportive, etj.);
- Organizimi i aktivitete të larmishme studentore çdo semestër;
- Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore të drejtuara nga stafi akademik (përmes moduleve si praktikë ose punë e kursit);
- Mbështetje me infrastrukturë (biblioteka, salla trajnimi, qendra sporti, etj.).

4.4. Indikatorë të matshëm (KPI):

- Rritje e aktiviteteve studentore;
- Rritje vjetore 10% e studentëve të përfshirë në aktivitete jashtë-mësimore;
- Shtim i numrit të studentëve që marrin pjesë në kërkime dhe publikime;

- Nxitja, themelimi dhe mbështetja e klubeve të reja studentore

V. Ruajtja e Zhvillimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me shkollat e mesme dhe komunitetin

5.1. Qëllimi Strategjik:

Të forcohen lidhjet e Fakultetit me institucionet e përkujdesit 0-3 vjeç, institucionet parashkollore, shkollat e arsimit parauniversitar, qendrat e përkujdesit dhe komunitetin lokal/rajonat, duke ndikuar në orientimin e të rinjve dhe duke konsoliduar rolin e FE si një aktor aktiv shoqëror.

5.2. Objektivat specifike:

- Ndërtimi i urave të komunikimit të vazhdueshëm me institucionet e përkujdesit dhe te arsimit;
- Rritja e njohjes së FE në komunitetet lokale dhe rajonale;
- Zhvillimi i rolit edukativ dhe informues të FE në shoqëri.

5.3. Nisma të propozuara:

- Krijimi i një Kalendarit Vjetor të Vizitave në Institucionet e interesit në bashkëpunim me DAR-të dhe mësuesit e karrierës, si dhe me institucionet nga ku ka ndërvartësi;
- Realizimi i ditëve të hapura në FE për nxënësit e viteve të fundit të shkollave të mesme;
- Bashkëpunim me bashkitë për projekte kulturore, edukative dhe rinore;
- Promovimi i programeve të studimit me broshura, video dhe prezantime në shkolla, qendra dhe institucione.

5.4. Indikatorë të matshëm (KPI):

- Shtim i përvitshëm i numrit të institucioneve dhe qendrave të vizituara;
- Shtim i përvitshëm i numrit të pjesëmarrësve në “Ditën e Hapur” në FE;
- Rritje e aplikimeve nga maturantët që kanë marrë pjesë në aktivitete të FE;
- Aplikim të përvitshme për projekte komunitare.

VI. Kërkimi Shkencor në FE

6.1. Roli i kërkimit shkencor në profilizimin dhe ndërkombëtarizimin e FE

Në kuadër të strategjisë së zhvillimit të UAMD-së dhe ndërkombëtarizimit, kërkimi shkencor në Fakultetin e Edukimit është shtylla që lidh drejtpërdrejt:

- cilësinë akademike (kurrikula të bazuara në evidencë, pedagogji moderne);
- ndërkombëtarizimin (bashkëpunime kërkimore, publikime me bashkautorësi, projekte të përbashkëta);
- rankimin institucional (publikime Scopus/WoS, citime, ndikim shoqëror);
- ndikimin në komunitet (politika arsimore, shëndet mendor në shkollë, zhvillim profesional i mësuesve).

FE-UAMD duhet të pozicionohet si një fakultet që prodhon kërkim të aplikueshëm në

arsimin parauniversitar dhe universitar: vlerësim, didaktikë, përfshirje, digjitalizim në arsim, psikologji edukimi, sociologji arsimit dhe politika sociale dhe arsimore.

6.2. Vizioni dhe misioni i kërkimit shkencor në FE

Vizioni:

Të afirmohet si një qendër reference në Shqipëri dhe rajon për kërkimin në edukim, pedagogji dhe shkenca psiko-sociale, me ndikim të matshëm në cilësinë e arsimit, në inovacionin pedagogjik dhe në integrimin evropian të praktikave akademike.

Misioni:

Të zhvillojë kërkim cilësor, të qëndrueshëm dhe ndërkombëtar, të lidhur me nevojat reale të sistemit arsimor dhe komunitetit, përmes:

- grupeve kërkimore dhe laboratorëve tematikë,
- publikimeve në revista të indeksuara,
- partneriteteve dhe projekteve me universitete të huaja,
- transferimit të rezultateve në politika dhe praktikë (schools/community impact).

6.3. Objektivat strategjikë 2025–2030 për kërkimin në FE

6.3.1 Forcimi i kapaciteteve kërkimore dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

- Krijimi i grupeve kërkimore të FE (interdisiplinore) dhe lidhja e tyre me partnerë ndërkombëtarë (sidomos partnerët e programeve të dyfishta/joint).
- Rritja e publikimeve me bashkautorësi ndërkombëtare, si indikator direkt i ndërkombëtarizimit.

6.3.2 Strukturë e brendshme kërkimore në FE (2030)

Në linjë me Institutin Kërkimor Nderdisiplinor të UAMD-së, FE organizon kapacitetet e veta si:

- **Njësia e Kërkimit në Edukim (FE Research Unit):** koordinim temash, thirrje të brendshme, mentorim, etikë, data management.
- **Klasterë kërkimorë tematikë** (shembuj):
 1. Edukimi Digjital & AI në Mësimdhënie
 2. Psikologji Edukimi, Well-being & Këshillim
 3. Edukimi Gjithëpërfshirës & NEAE/ABA/ADHD
 4. Didaktika e Gjuhëve, Literacy & Multilingualism
 5. Sociologji Arsimit, Migracion & Diversitet

6.3.3 Sigurimi dhe rritja e fondeve kërkimore

- Rritje graduale e financimeve për kërkimin brenda FE për: mini-grante, konferenca, publikime, vizita kërkimore.
- Diversifikim i burimeve përmes:
 - Erasmus+ (KA2/CBHE, Partnerships),
 - Horizon Europe (kur FE lidhet me tema si “Digital Education”, “Inclusion”, “Mental Health”, “Societal Resilience” etj.),
 - bashkëpunime me institucione publike (MAS, DAR/ZA, bashki),
 - partneritete me sektorin privat (edtech, testim, trajnime).

6.3.4 Kontribut në indeksimin dhe reputacionin shkencor (revista & botime)

FE ka rol kyç në forcimin e botimeve të UAMD-së:

- rritje e artikujve me autorë ndërkombëtarë,
- nxitje për publikime në revista Scopus/WoS.

6.3.5 Përmirësimi i rankimit dhe impaktit (2030)

FE kontribuon në rankime kryesisht përmes:

- publikimeve të indeksuara,
- citimeve,
- projekteve ndërkombëtare,
- ndikimit në SDG (p.sh. SDG 4 – Quality Education, SDG 3 – Well-being, SDG 5 – Gender Equality).

6.3.6 Rritja e cilësisë së kërkimit dhe kulturës akademike

- Trajnime periodike mbi: shkrim shkencor, metodologji, statistikë/analizë, etikë, open science, grant writing.
- Mentorim për doktorantë dhe studiues të rinj.
- Konferenca/workshope të rregullta të FE (të paktën 1 aktivitet ndërkombëtar çdo vit).

6.4. Mekanizmat kryesorë të zbatimit në FE (2030)

(A) “Research Groups + International Co-authorship”

- çdo departament të ketë të paktën 1 grup kërkimor aktiv (me plan vjetor).
- çdo grup të ketë 1 partner të huaj (co-supervision, co-authorship).

(B) “Grant Pipeline” (nga ide → aplikim)

- bankë ide-projektesh,
- kalendar thirrjesh (Erasmus/Horizon/CBHE),
- ekip i vogël mbështetës për aplikime (template, buxhet, logframe).

(C) Open Science & etikë

- protokolle për etikën kërkimore (sidomos kërkim me nxënës/mësues),
- menaxhim i të dhënave (FAIR principles),
- repo institucional për punime/raporte (ku është e mundur).

(D) Lidhja kërkim–mësimdhënie

- rezultate kërkimore të kthehen në module/mikrokredite,
- praktika në shkolla të shoqërohet me kërkim të aplikueshëm (action research).

6.5. KPI të matshëm për FE (2025–2030)

Deri në 2027:

- +50% rritje e publikimeve me bashkautorësi ndërkombëtare (si target i UAMD, i përkthyer në FE).
- minimum 2 grupe kërkimore aktive në fakultet brenda departamenteve ose nderdipartimental.
- të paktën 1 aplikim në vit në një thirrje ndërkombëtare (Erasmus+/Horizon/CBHE) me FE si co-applicant.

Deri në 2030:

- rritje vjetore e publikimeve në revista të indeksuara (Scopus/WoS) nga stafi i FE.
- 1 konferencë ndërkombëtare në vit (të dokumentuar me proceedings/ISBN).
- 60% e stafit të FE i trajnuar në grant writing, open science, etikë dhe metodologji kërkimi.
- përfshirje aktive në indikatorë SDG (raporte, projekte, publikime me SDG 4).

6.6. Fazat e zbatimit (të harmonizuara me UAMD)**Faza I (2025–2027) – Konsolidimi**

- ngritja e Njesisë së Kërkimit në FE dhe klasterëve tematikë;
- plan vjetor i trajnimeve + mentorim;
- sistem i thjeshtë i stimujve (konferenca/APC/seed grants);
- standardet e etikës kërkimore dhe data management.

Faza II (2027–2030) – Zgjerimi

- rritje e aplikimeve në projekte ndërkombëtare;
- bashkautorësi ndërkombëtare sistematike;
- konferencë ndërkombëtare e përvitshme/bi-vjetore;
- lidhje më e fortë kërkim–mikrokredite–shkolla.

(Perspektivë 2030–2040) – në linjë me UAMD

- FE si qendër rajonale për “Education Innovation & Digital Pedagogy”
- postdoctoral fellows, doktoratura të përbashkëta, shkolla verore kërkimore.

6.7. Monitorimi dhe rezultatet e pritshme**Monitorimi realizohet përmes:**

- raportimit vjetor të FE (publikime, citime, projekte, mobilitet, aktivitete),
- vlerësim periodik i grupeve kërkimore (output + impact).

Rezultatet e pritshme (deri 2030):

- kulturë kërkimore më aktive dhe e ndërkombëtarizuar në FE,
- rritje e publikimeve të indeksuara dhe bashkautorësisë,
- rritje e projekteve dhe fondeve,
- ndikim më i matshëm në politikat/praktikat arsimore (p.sh. udhëzues, trajnime, raporte për institucione).

Kërkimi shkencor është themeli mbi të cilin do të ndërtohet reputacioni i FE-së në të ardhmen. Zhvillimi, sigurimi i fondeve për projekte kërkimore; rritja e cilësisë së kërkimit dhe trajtimi meritokratik i stafit përbëjnë shtyllat kryesore që duhet të plotësohen.

VII. Përfshirja e FE-së në projekte kërkimore – shkencore

7.1. Strategjia dhe Vizioni

Në përputhje me Strategjinë e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës 2025–2030, Fakulteti i Edukimit e konsideron përfshirjen në projekte kërkimore dhe ekosisteme inovacioni si mekanizëm kryesor për rritjen e cilësisë akademike, ndërkombëtarizimin dhe ndikimin shoqëror.

Vizioni i FE është të zhvillohet si një njësi akademike lider në projekte kërkimore në fushën e edukimit, psikologjisë dhe inovacionit pedagogjik, duke integruar kërkimin shkencor me mësimdhënien dhe transferimin e njohurive.

7.2. Përfshirja në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare

FE synon rritjen sistematike të pjesëmarrjes në programe si:

- Erasmus+ (Teacher Education, Inclusion, Digital Education)
- Horizon Europe (Society, Education, Digital transformation)
- COST Actions
- EIT HEI initiatives
- projekte kombëtare në arsim dhe psikologji
- projekte me donatorë ndërkombëtarë

Fushat prioritare:

- edukimi digjital dhe AI
- edukimi gjithëpërfshirës
- edukim në vazhdim
- mirëqenia e nxënësve
- përkujdesje dhe shërbime sociale
- inovacion pedagogjik
- politika arsimore dhe sociale
- zhvillimi profesional i mësuesve

Projektet do të lidhen drejtpërdrejt me:

- publikime shkencore
- zhvillim kurrikule
- doktoratura
- ndikim në politika publike

7.3. Ndikimi i projekteve në zhvillimin e fakultetit

Përfshirja sistematike e Fakultetit të Edukimit në projekte kërkimore-shkencore dhe në ekosisteme inovacioni përfaqëson një mekanizëm thelbësor për transformimin institucional dhe rritjen e cilësisë akademike. Projektet kontribuojnë jo vetëm në prodhimin e njohurive të reja, por edhe në modernizimin e proceseve të mësimdhënies, në forcimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe në lidhjen e universitetit me komunitetin dhe tregun e punës.

Në këtë kuadër, ndikimi kryesor i projekteve reflektohet në disa dimensione:

- **Rritja e fondeve kërkimore**, përmes pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare dhe bashkëpunimeve institucionale, duke krijuar burime shtesë për zhvillimin e infrastrukturës, trajnimin e stafit dhe realizimin e aktiviteteve shkencore.
- **Rritja e publikimeve të indeksuara dhe impaktit shkencor**, pasi projektet nxisin prodhimin e rezultateve kërkimore të strukturuar, bashkautorësinë ndërkombëtare dhe citueshmërinë akademike.
- **Ndërkombëtarizimi real i fakultetit**, nëpërmjet rrjeteve kërkimore, projekteve të përbashkëta, mobiliteteve akademike dhe integritit në iniciativa evropiane të inovacionit dhe edukimit.
- **Zgjerimi i mundësive për studentët**, përmes përfshirjes në kërkim, praktikave, projekteve pilot dhe aktiviteteve inovative, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave kërkimore dhe profesionale.
- **Zhvillimi i laboratorëve dhe qendrave kërkimore**, veçanërisht në fushat e edukimit digjital, psikologjisë së edukimit dhe inovacionit pedagogjik, duke përmirësuar kapacitetet infrastrukturore të fakultetit.
- **Modernizimi i kurrikulës**, pasi rezultatet e projekteve integrohen në programet e studimit, metodologjitë e mësimdhënies dhe zhvillimin e kurseve të reja të orientuara drejt kompetencave të shekullit XXI.
- **Rritja e reputacionit institucional**, përmes dukshmërisë ndërkombëtare, pjesëmarrjes në rrjete akademike dhe kontributit në zhvillimin e politikave arsimore dhe inovacionit shoqëror.

Në tërësi, projektet funksionojnë si katalizator për zhvillimin e qëndrueshëm të fakultetit, duke lidhur kërkimin shkencor me mësimdhënien, inovacionin dhe ndikimin shoqëror, dhe duke konsoliduar rolin e Fakultetit të Edukimit si një aktor aktiv në hapësirën akademike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Projektet shërbejnë si mekanizëm për transformimin e fakultetit në një njësi kërkimore-inovative.

7.4. Treguesit e suksesit (KPIs)

Për të monitoruar progresin e Fakultetit të Edukimit në përfshirjen në projekte kërkimore dhe ekosisteme inovacioni, do të përdoren tregues të matshëm që reflektojnë zhvillimin e kapaciteteve kërkimore, ndërkombëtarizimin dhe ndikimin akademik.

Treguesit kryesorë përfshijnë:

- **Rritja e numrit të projekteve ndërkombëtare me pjesëmarrje të FE**, duke synuar zgjerimin e rolit të fakultetit nga partner në bashkëdrejtues apo koordinator projektësh.
- **Vlera e fondeve të siguruara nga projekte kërkimore**, si indikator i kapaciteteve institucionale për tërheqjen e financimeve konkurruese dhe zhvillimin e infrastrukturës kërkimore.
- **Numri dhe cilësia e publikimeve që rrjedhin nga projektet**, veçanërisht në revista të indeksuara ndërkombëtarisht, si dhe rritja e bashkautorësisë ndërkombëtare dhe citimeve.
- **Përfshirja e studentëve në kërkim**, e matur përmes pjesëmarrjes në projekte, praktikave kërkimore, temave të diplomës dhe aktiviteteve inovative të lidhura me projektet.

- **Zgjerimi i partneriteteve ndërkombëtare**, përmes marrëveshjeve kërkimore, rrjeteve akademike dhe projekteve të përbashkëta me universitete dhe institucione kërkimore.
- **Krijimi dhe përmirësimi i laboratorëve dhe qendrave kërkimore**, si tregues i zhvillimit të kapaciteteve infrastrukturore dhe të kërkimit aplikativ.
- **Ndikimi i projekteve në zhvillimin e kurrikulës**, përmes kurseve të reja, metodologjive inovative dhe integritit të rezultateve kërkimore në procesin mësimor.
- **Kontributi në politika publike dhe komunitet**, i matur përmes raporteve, udhëzuesve profesionalë dhe bashkëpunimeve me institucione arsimore dhe organizata.

Këta tregues do të monitorohen në mënyrë periodike dhe do të përdoren për vlerësimin e performancës kërkimore, planifikimin strategjik dhe raportimin institucional.

7.5. Fazat e zbatimit

Zbatimi i strategjisë për përfshirjen e Fakultetit të Edukimit në projekte kërkimore dhe ekosisteme inovacioni do të realizohet në mënyrë të fazuar, duke siguruar konsolidimin gradual të kapaciteteve institucionale dhe zgjerimin e rolit të fakultetit në hapësirën akademike ndërkombëtare.

Faza I (2025–2027) – Konsolidimi i kapaciteteve

Në këtë periudhë do të ndërtohen bazat institucionale për pjesëmarrjen në projekte. Do të krijohet një strukturë funksionale për koordinimin e projekteve, dhe do të zhvillohen aplikime pilot në programe kombëtare dhe ndërkombëtare. Paralelisht do të organizohen trajnime për shkrimin e projekteve (grant writing), mentorim për stafin.

Faza II (2027–2030) – Zgjerimi dhe konsolidimi ndërkombëtar

Në këtë fazë synohet rritja e pjesëmarrjes në projekte të mëdha ndërkombëtare dhe marrja e roleve më aktive në konsorciume kërkimore. Do të forcohet integrimi i rezultateve të projekteve në kurrikulë, metodologji mësimore dhe zhvillim profesional të stafit.

Perspektiva afatgjatë (2030–2040) – Pozicionimi strategjik

Në perspektivë afatgjatë synohet institucionalizimi i kërkimit ndërkombëtar përmes doktoraturave të përbashkëta, krijimit të një research hub në fushën e edukimit. Fakulteti i Edukimit do të synojë të pozicionohet si aktor rajonal në projekte inovative në edukim, duke kontribuar në rrjete ndërkombëtare kërkimore dhe në zhvillimin e politikave arsimore të bazuara në evidencë.

Përfshirja e FE në projekte kërkimore-shkencore përfaqëson një shtyllë thelbësore të planit të zhvillimit të fakultetit. Përmes një qasjeje të integruar që lidh kërkimin, mësimdhënien dhe sipërmarrjen akademike, FE do të forcojë kapacitetet kërkimore, do të rrisë ndërkombëtarizimin dhe do të kontribuojë në transformimin e universitetit në një aktor inovativ në arsimin e lartë.

VIII. Rrjetëzimi Akademik dhe Potenciali Gjeografik i FE

Fakulteti i Edukimit synon të konsolidojë pozicionin e tij në arenën ndërkombëtare përmes përfshirjes aktive në rrjete akademike evropiane dhe globale në fushën e edukimit, formimit të mësuesve dhe kërkimit pedagogjik, në përputhje me orientimin strategjik të Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Përfshirja në rrjete ndëruniversitare forcon identitetin akademik të Fakultetit, rrit vizibilitetin ndërkombëtar dhe krijon mundësi për:

- zhvillimin e programeve të përbashkëta dhe diplomave duale në edukim;
- mobilitet të strukturuar të stafit dhe studentëve;
- projekte kërkimore të përbashkëta në fushën e arsimit;
- shkëmbim praktikash të mira pedagogjike;
- ndikim në politika arsimore në nivel rajonal dhe evropian.

8.1. Strategjia dhe Vizioni

Qëllimi i Fakultetit të Edukimit është të pozicionohet si një njësi akademike aktive dhe e dukshme në rrjetet ndërkombëtare të arsimit, duke kontribuar në debatet dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e:

- inovacionit pedagogjik,
- edukimit digjital,
- formimit të mësuesve,
- edukim në vazhdim
- mirëqenia e nxënësve
- përkujdesje dhe shërbime sociale
- inovacion pedagogjik
- politika arsimore dhe sociale
- barazisë dhe përfshirjes në arsim,
- zhvillimit të qëndrueshëm përmes edukimit.

Pjesëmarrja aktive në rrjete do të shërbejë si katalizator për:

- rritjen e cilësisë së kurrikulave;
- përmirësimin e kërkimit shkencor në edukim;
- ndërkombëtarizimin e përmbajtjeve mësimore;
- krijimin e mundësive për programe të përbashkëta studimi në afatmesëm.

8.2. Aktivitetet e Sugjeruara në Nivel Fakulteti

- Identifikimi i rrjeteve më të përshtatshme për profilin e FE me qëllim antarësimin.
- Hartëzimi i aplikimeve për anëtarësim dhe ndërtimi i materialve të profilit institucional (si psh. statistika, programe, projekte, publikime).
- Përgatitja e stafit akademik dhe studentëve për përfaqësim aktiv në konferenca dhe projekte të rrjeteve.
- Ndërtimi i partneriteteve rajonale për projekte të përbashkëta.
- Zgjerimi i bashkëpunimeve jashtë Evropës

Përfitimet për FE:

- Rritja e vizibilitetit ndërkombëtar dhe reputacionit akademik.
- Mundësi për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare dhe sigurimi i fondeve kërkimore.
- Rritje e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ.
- Transferim i njohurive dhe praktikave të mira nga universitetet më të zhvilluara.
- Zhvillim i programeve të përbashkëta studimi dhe kurrikulave ndërkombëtare.
- Forcim i bashkëpunimit rajonal dhe hapje ndaj tregjeve akademike globale.

8.3. Treguesit e Suksesit (KPIs)

- Numri i rrjeteve ndërkombëtare ku FE është anëtar aktiv.
- Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara e.
- Numri i projekteve të aplikuara dhe fituara në partneritet.
- Pjesëmarrja e stafit dhe studentëve në evente ndërkombëtare (konferenca, seminare, trajnime).
- Numri i programeve të përbashkëta studimi të zhvilluara me partnerët ndërkombëtarë.
- Raportet vjetore mbi impaktin e rrjeteve në ndërkombëtarizimin e FE.

IX. Bashkëpunimi me Diasporën

Fakulteti i Edukimit e konsideron diasporën shqiptare një potencial strategjik për ndërkombëtarizimin e formimit të mësuesve dhe zhvillimin e kërkimit pedagogjik. Përfshirja e akademikëve, profesionistëve dhe studentëve të diasporës në jetën akademike të Fakultetit do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, në transferimin e praktikave ndërkombëtare dhe në forcimin e dimensionit global të programeve të studimit.

Në përputhje me orientimin strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti synon të krijojë ura të qëndrueshme bashkëpunimi me diasporën akademike përmes:

- ftesës së lektorëve dhe studiuesve të diasporës për cikle leksionesh dhe mentorim;
- përfshirjes së ekspertëve në projekte kërkimore të përbashkëta;
- organizimit të aktiviteteve akademike me fokus në arsimin dhe identitetin kulturor;
- angazhimit të studentëve të diasporës në programe studimi dhe shkolla verore.

9.1. Strategjia dhe Vizioni në Nivel Fakulteti

Fakulteti i Edukimit synon të shndërrohet në një pikë referimi për bashkëpunimin me diasporën në fushën e edukimit, nëpërmjet:

- shkëmbimit të përvojave pedagogjike ndërkombëtare;
- zhvillimit të projekteve të përbashkëta kërkimore;
- promovimit të identitetit kulturor dhe gjuhësor në kurrikula;
- transferimit të praktikave më të mira evropiane në formimin e mësuesve.

Ky bashkëpunim lidhet drejtpërdrejt me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, veçanërisht me arsimin cilësor dhe partneritetet ndërkombëtare.

9.2. Integrimi në rrjetet e diasporës akademike

Në nivel fakulteti, masat do të përfshijnë:

- hartëzimin e ekspertizës së diasporës në fushën e edukimit (Itali, Gjermani, SHBA, Kanada, Kosovë, Maqedoni e Veriut, etj.);
- organizimin e aktiviteteve akademike me pjesëmarrje të studiuesve të diasporës;
- përfshirjen e stafit dhe studentëve në rrjete ekzistuese akademike të diasporës;
- zhvillimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për projekte dhe mobilitete.

Indikatorë të përmbledhur:

- numri i lektorëve të diasporës të angazhuar
- numri i aktiviteteve të përbashkëta akademike;
- numri i projekteve ose publikimeve në bashkëpunim me diasporën.

9.3. Bashkëpunimi me Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe dimensionit kulturor, Fakulteti i Edukimit do të thellojë bashkëpunimin me

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, veçanërisht në fushat që lidhen me:

- edukimin ndërkulturor;
- ruajtjen dhe promovimin e gjuhës arbëreshe;
- kërkimin në albanologji dhe histori kulturore;
- përfshirjen e studentëve në projekte dokumentimi dhe studimore.

Ky bashkëpunim mund të konkretizohet përmes:

- botimeve dhe konferencave të përbashkëta;
- aplikimeve të përbashkëta në projekte kombëtare dhe evropiane.

X. Integrimi i Praktikave Profesionale në kurrikulat e programeve të Fakultetit të Edukimit dhe internship-i studentor

10.1 Qëllimi Strategjik

Në përputhje me orientimin institucional për rritjen e punësimit dhe forcimin e lidhjes ndërmjet universitetit dhe tregut të punës, Fakulteti i Edukimit e konsideron praktikën profesionale pedagogjike dhe internship-in studentor si shtyllë themelore të formimit universitar. Integrimi i praktikave në kurrikulë nuk përbën vetëm një komponent teknik të programeve të studimit, por një mekanizëm thelbësor për zhvillimin e kompetencave profesionale, përgjegjësisë etike dhe autonomisë pedagogjike të studentëve.

Fakulteti synon që praktika profesionale të jetë e detyrueshme, progresive dhe e strukturuar në të gjitha programet e studimit, duke u ndërtuar në mënyrë të tillë që të shoqërojë studentin nga fazat e para të formimit teorik deri në përballjen e drejtpërdrejtë me realitetin arsimor dhe social. Përmes këtij integrimi, synohet që çdo student të pajiset me përvojë konkrete në institucione arsimore dhe struktura të tjera relevante për profilin e tij profesional.

Një element thelbësor i modelit të praktikave profesionale pedagogjike është mentorimi i dyfishtë, i strukturuar dhe i koordinuar ndërmjet institucionit pritës dhe Fakultetit të Edukimit. Ky mekanizëm synon të garantojë cilësinë e përvojës praktike dhe zhvillimin profesional të studentit në mënyrë të mbështetur, të reflektuar dhe të vlerësuar.

Mentorimi realizohet nëpërmjet dy figurave kyçe:

Mentori, është personi me përvojë në institucionin e përkujdesit, institucionin parashkollor dhe atë të arsimit parauniversitar ku studenti zhvillon praktikën, i cili ka rol themelor në orientimin e studentit në mjedisin real të punës. Ai e udhëzon studentin në planifikimin e orës mësimore, në menaxhimin e grupit, në përdorimin e metodave aktive dhe në ndërveprimin me nxënësit/fëmijët, prindërit dhe stafin. Mentori monitoron progresin e studentit, ofron feedback të vazhdueshëm profesional dhe kontribuon në vlerësimin e performancës së tij në terren.

Udhëheqësi pedagogjik, si përfaqësues i Fakultetit të Edukimit, ka përgjegjësinë për të siguruar lidhjen organike ndërmjet përvojës praktike dhe formimit teorik universitar. Ai ndjek zhvillimin e praktikës, organizon seanca reflektimi akademik, orienton studentin në analizën kritike të situatave dhe garanton që objektivat mësimore të praktikës të përmbushen në përputhje me standardet e programit të studimit. Udhëheqësi pedagogjik luan rol kyç në standardizimin e vlerësimit dhe në harmonizimin e praktikës me kompetencat që kërkohen nga profili profesional i diplomës.

Bashkëveprimi i këtyre dy roleve krijon një strukturë të qëndrueshme mbështetjeje, ku studenti nuk është thjesht praktikant, por pjesë aktive e një procesi të mirëorganizuar formimi profesional. Përmes këtij modeli, Fakulteti synon të forcojë cilësinë e praktikës, të rrisë përgjegjësinë profesionale dhe të garantojë që përvoja në terren të shndërrohet në kompetencë të qëndrueshme dhe të certifikueshme.

10.2 Vizioni

Fakulteti i Edukimit synon të ndërtojë një model të qëndrueshëm të praktikave profesionale, ku teoria dhe praktika të ndërthuren në mënyrë organike gjatë gjithë ciklit të studimeve. Praktika nuk do të jetë një fazë e izoluar në fund të programit, por një proces i vazhdueshëm formimi, që fillon që në vitin e parë dhe rritet gradualisht në kompleksitet dhe përgjegjësi.

Në këtë model, studentët kalojnë nga observimi i strukturuar i proceseve mësimore dhe institucionale, në përfshirje aktive si asistentë, e deri në zhvillimin e plotë të proceseve të mësimdhënies dhe shërbimit, të mbikëqyrur dhe ndërhyrjeve të pavarura. Çdo fazë e praktikës shoqërohet me reflektim profesional, analizë të përvojës në terren dhe dokumentim të arritjeve përmes portofolit, i cili shërben si dëshmi e zhvillimit të kompetencave.

Mentorimi i dyfishtë përbën themelin e këtij vizioni. Bashkëveprimi ndërmjet mentorit dhe udhëheqësit pedagogjik siguron që përvoja në terren të mos mbetet episodike, por të shndërrohet në proces të strukturuar formimi profesional. Përmes këtij bashkëpunimi institucional, Fakulteti garanton që praktika të jetë e orientuar drejt standardeve të cilësisë, drejt reflektimit kritik dhe drejt përgatitjes reale për profesionin dhe profesionistit.

Internship-i studentor konceptohet si hap i ndërmjetëm mes studimit universitar dhe punësimit, duke ofruar mundësi reale për përfshirje në institucione arsimore, qendra sociale dhe organizata të tjera relevante për fushën e edukimit. Përmes këtij mekanizmi, Fakulteti synon të krijojë një tranzicion të butë dhe të strukturuar nga arsimi drejt profesionit.

Të diplomuarit në Fakultetin e Edukimit zotërojnë jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi konkrete didaktike, menaxhimi, përdorimi të teknologjisë në mësimdhënie dhe përvojë të dokumentuar në mjedise reale. Në këtë mënyrë, praktikat profesionale shndërrohen në një element identitar të Fakultetit të Edukimit dhe në një garanci cilësie për formimin e profesionistëve të ardhshëm.

10.3 Objektivat Strategjike

Fakulteti i Edukimit

Integrimi i praktikave profesionale në Fakultetin e Edukimit përbën një dimension identitar të formimit universitar. Përgatitja e mësuesve dhe profesionistëve kërkon një ndërthurje të vazhdueshme midis teorisë dhe praktikës, ku përvoja në terren është thelbësore për zhvillimin e kompetencave reale profesionale.

Në këtë kuadër, Fakulteti i Edukimit përcakton objektivat strategjike si vijon:

- ***Integrimi i plotë kurrikular i praktikës profesionale***

Fakulteti synon që praktikat profesionale dhe internship-i studentor të jenë pjesë e detyrueshme e të gjitha programeve të studimit, duke u strukturuar progresivisht gjatë gjithë ciklit akademik.

Kjo nënkupton:

- Përfshirjen e praktikave me kredite ECTS të qarta dhe të matshme.
- Zhvillimin e praktikës në disa faza:
 - Observim i drejtuar në institucionet.
 - Asistencë dhe bashkë-mësimdhënie apo bashkeveprim.
 - Mësimdhënie dhe shërbim i mbikëqyrur dhe ndërhyrje pedagogjike.
- Lidhjen e drejtpërdrejtë të praktikës me lëndët e didaktikës, psikologjisë së të nxënit, menaxhimit të grupit dhe teknologjisë arsimore.
- Reflektim akademik përmes seminareve, workshopeve dhe prezantimeve të përvojës praktike.
- Dokumentim të kompetencave përmes portofolit të praktikës.

Ndërtimi i partneriteteve të qëndrueshme me institucionet e përkujdesjes, institucionet parashkollore dhe ato të arsimit parauniversitar

Duke qenë se misioni kryesor i Fakultetit të Edukimit lidhet me formimin e profesionistëve, prioritet absolut përbën ndërtimi i një rrjeti të konsoliduar institucionesh partnere.

Fakulteti do të:

- Krijojë një rrjet “Institucione Partnerë të Fakultetit të Edukimit”.
- Nënshkruajë marrëveshje afatgjata me shkolla 9-vjeçare dhe gjimnaze.
- Nënshkruajë marrëveshje afatgjata me institucionet e përkujdesit
- Përfshijë qendra shërbimi social për programet profesionale
- Përfshijë kopshte dhe qendra edukimi parashkollor për programet përkatëse.
- Garantojë kuota të përvitshme për studentët praktikantë.
- Organizojë trajnime të përbashkëta për mentorët shkollorë.
- Përfshijë alumni të suksesshëm si institucione pritëse.

Ky rrjet synon të krijojë stabilitet, cilësi dhe vazhdimësi në përvojën praktike të studentëve.

- ***Standardizim dhe garantim i cilësisë së praktikës profesionale***

Fakulteti do të ndërtojë një sistem të unifikuar cilësie që përfshin:

- Manual të praktikës profesionale me objektiva të qarta kompetencash.
- Trajnim periodik për mentorët dhe udhëheqësit pedagogjikë.

- Integrim të praktikës në sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Standardizimi do të harmonizohet me kornizën kombëtare të cilësisë dhe standardet evropiane ESG/ENQA.

- ***Mentorim i dyfishtë i strukturuar***

Mentorimi përbën shtyllën kryesore të cilësisë së praktikës profesionale.

Çdo student i Fakultetit të Edukimit do të mbështetet nga:

- Mentori në institucionin pritës, i cili garanton orientimin praktik në terren dhe integrimin e studentit në jetën e institucionit
- Udhëheqësi pedagogjik nga Fakulteti, i cili siguron lidhjen e praktikës me kurrikulën dhe organizon reflektimin profesional.

Ky model garanton që përvoja në terren të jetë e mbikëqyrur, e analizuar dhe e vlerësuar në mënyrë të strukturuar.

- Ndërkombëtarizimi i praktikave profesionale

Fakulteti do të nxisë mobilitetin ndërkombëtar përmes:

- Erasmus+
- CEEPUS
- Marrëveshjeve bilaterale
- BIPs në bashkëpunim me partnerët e Aleancës STARS EU. BIPs do të përdoren si mekanizëm për integrimin e praktikës pedagogjike në kontekste ndërkombëtare, duke kombinuar mobilitetin fizik dhe komponentin virtual.

Integrimi i mikrokrediteve

Në funksion të rritjes së transparencës dhe transferueshmërisë së kompetencave, Fakulteti do të zhvillojë mikrokredite që do të shërbejnë si mekanizëm:

- për certifikimin e kompetencave specifike
- për dokumentimin e rezultateve të të nxënit
- për rritjen e punësueshmërisë
- për njohjen ndërkombëtare të aftësive profesionale
- Këto mikrokredite do të jenë të dizajnuara sipas:
- rezultateve të matshme të të nxënit
- krediteve ECTS
- standardeve evropiane për mikro-kualifikimet
- integritet me portofolin profesional të studentit

10.4 Implementimi

Strukturat e konsoliduara dhe mekanizmat e koordinimit

Në kuadër të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit 2025–2030, Fakulteti i Edukimit do të mbështetet në strukturat ekzistuese institucionale, duke forcuar rolin dhe koordinimin ndërmjet tyre për garantimin e ndërkombëtarizimit të praktikave.

Fakulteti do të:

- Forcojë rolin e Koordinatorit të Praktikës profesionale si pikë referimi për organizimin, monitorimin dhe zhvillimin e praktikave kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Integrojë funksionin e praktikës ndërkombëtare në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Zyrën e Karrierës dhe Alumnit.
- Sigurojë koordinim të vazhdueshëm ndërmjet:
 - Koordinatorit të Praktikës,
 - Udhëheqësve pedagogjikë,
 - Mentorëve,
- Përcaktojë qartë përgjegjësitë institucionale për:
 - Marrëveshjet ndërkombëtare të praktikës,
 - Monitorimin e mobilitetit praktik,
 - Integrimin e mikrokrediteve dhe BIPs.
- Zhvillojë një sistem të përbashkët raportimi për praktikat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky model synon të sigurojë që ndërkombëtarizimi i praktikave të mos trajtohet si aktivitet i veçantë, por si proces i integruar në strukturën akademike dhe administrative të Fakultetit.

10.5 Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi dhe vlerësimi i ndërkombëtarizimit të praktikave do të realizohet përmes një sistemi të integruar institucional, që kombinon vlerësimin akademik, analizën e tregut të punës dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë.

Procesi do të përfshijë:

- Raporte periodike nga studentët dhe mentorët (shkollorë dhe akademikë), me fokus në cilësinë e përvojës praktike dhe dimensionin ndërkombëtar.
- Vlerësimin e kompetencave të fituara përmes portofolit profesional (e-portfolio), duke dokumentuar zhvillimin e aftësive të kërkuara.
- Studime të ndjekjes së karrierës së të diplomuarve (tracer study), me fokus të veçantë në punësimet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Analizë periodike të tregut të punës në sektorin arsimor, për të përshtatur përmbajtjen dhe strukturën e praktikave.
- Raporte vjetore nga Zyra e Karrierës dhe Alumnit në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
- Integrim të të dhënave në raportin institucional të ndërkombëtarizimit të Fakultetit.

Ky sistem do të garantojë përmirësim të vazhdueshëm dhe përshtatje dinamike me kërkesat kombëtare dhe evropiane të formimit të mësuesve.

10.6 Rezultatet e pritshme për Fakultetin e Edukimit

Në kuadër të ndërkombëtarizimit të praktikave pedagogjike, priten rezultatet e mëposhtme:

- Çdo student i Fakultetit të Edukimit të përfitojë përvojë reale, me dimension kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Rritje e ndjeshme e punësimit të diplomuarve, veçanërisht në tregun evropian të punës.
- Konsolidim i Fakultetit të Edukimit si qendër e ekselencës për formimin praktik dhe ndërkombëtar të mësuesve.
- Zgjerim dhe institucionalizim i rrjetit të partneriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Diploma e Fakultetit të Edukimit të shoqërohet me kompetenca të demonstrueshme, të certifikuar dhe të transferueshme ndërkombëtarisht.

- Rritje e vizibilitetit evropiane të Fakultetit të Edukimit përmes BIPs, mikrokrediteve dhe mobilitetit praktik.

XI. Zhvillimi i Masterplanit për një kampus bashkëkohor e modern

11.1. Vizioni

Kampusin e ardhshëm e karakterizojnë tre shtylla kryesore:

➤ *Kampus akademik Cilësor*

- Deri në vitin 2030, kampusi synon të garantojë kushte të përparura për mësimdhënie dhe kërkim shkencor, përmes infrastrukturës së re, laboratorëve modernë dhe bibliotekës qendrore digjitale.

➤ *Kampus digjital dhe inovativ*

- Në fazën 2025-2030, synohet të bëhet një kampus digjital përmes implementimit të sistemeve “smart campus” për menaxhimin e shërbimeve akademike dhe administrative.

Në këtë kuadër dhe Fakulteti i Edukimit do të mbështetet mbi cilësinë akademike, inovacionin, përfshirjen dhe përgjegjësinë sociale.

11.2. Misioni

Bazuar në misionin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Edukimit do të përfshihet në krijimin e një ekosistemi universitar gjithëpërfshirës, inovativ dhe të qëndrueshëm, i cili:

- Mbështet cilësinë akademike; garanton një përvojë të pasur studentore, duke nxitur integrimin social e kulturor të studentëve vendas, të trojeve dhe ndërkombëtarë.
- Digjitalizon shërbimet universitare, ku studentët dhe stafi kanë akses në shërbime akademike, administrative dhe sociale në mënyrë të shpejtë, efikase dhe transparente.
- Forcon ndërveprimin me komunitetin lokal dhe kombëtar, duke shërbyer si një qendër integrimi kulturor, shkencor dhe social për qytetin e Durrësit dhe duke ndërtuar ura bashkëpunimi me rrjete akademike e kërkimore evropiane dhe botërore.

11.3. Objektivat strategjikë

Fakulteti i Edukimit është pjesë e rëndësishme e masterplanit të UAMD-së që synon të harmonizojë cilësinë akademike, mirëqenien studentore, qëndrueshmërinë mjedisore dhe inovacionin.

Objektivat afatmesëm (2025–2030)

➤ *Modernizimi i infrastrukturës akademike*

- Rikonstruksioni i godinës së Fakultetit të Edukimit për të përmbushur standardet bashkëkohore të mësimdhënies.

- Krijimi i laboratorëve shkencorë të specializuar për gjuhët angleze, gjermane dhe psikologjinë.

➤ *Përmirësimi i kushteve të jetës studentore*

- Integrimi i shërbimeve sociale dhe mbështetëse për studentët (qendra karriere, shërbime psikologjike, këshillim akademik).

- Digjitalizimi i kampusit
- Implementimi i sistemeve “smart campus” për menaxhimin e orareve, hapësirave dhe shërbimeve universitare.
- Rritja e aksesit në internet me shpejtësi të lartë.

Objektivat afatgjatë (2035–2040)

- Kampus i integruar dhe i zgjeruar
 - Zgjerimi i infrastrukturës për të akomoduar shtimin e programeve studimore dhe popullsisë studentore ndërkombëtare.
 - Smart campus i avancuar
 - Integrimi i inteligjencës artificiale dhe teknologjive të avancuara për menaxhimin e burimeve dhe shërbimeve.
 - Automatizimi i plotë i proceseve administrative dhe akademike.
 - Diploma të dyfishta:
 - FE është në pritje të nënshkrimit të marrëveshjes me Fakultetin e Shkencave Politike, Sociologjisë, dhe Komunikimit të Universitetit La Sapienza të Romës për programin e përbashkët Master of Science in Management and Planning of Social Policies
 - Studime doktorate të përbashkëta me universitete evropiane.
 - FE aktualisht ofron programin e përbashkët të doktoratës në: "Didaktikë e Gjuhëve të Huaja" me Universitetin Constantine the Philosopher, Nitra Slovakia.
- Me këto programe të përbashkëta dhe të tjera krijohet mundësia e bashkëpunimit dhe e kontributit të personaliteteve të specializuar akademike

Faza të zbatimit

Faza I: Planifikimi dhe prioritetet e hershme (2025–2026)

- Rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e godinës së FE.

Faza II: Zhvillimi i infrastrukturës bazë (2027–2028)

- Përparim i ndjeshëm në digjitalizimin e shërbimeve universitare.
- Vendosja e sistemit fillestar për menaxhim digjital të shërbimeve (platformë “smart campus”).

Qasje transversale në të gjitha fazat

- Përfshirja e studentëve dhe stafit në procesin e vendimmarrjes.
- Rishikim i vazhdueshëm i prioritetëve sipas realiteteve ekonomike dhe demografike.

11.4. Monitorim dhe vlerësim

- Fakulteti i Edukimit dhe departamentet e tij janë përgjegjëse për zbatimin në nivel akademik, veçanërisht për laboratorët dhe shërbimet që u përkasin.

➤ Procesi i Monitorimit

- Fakulteti i Edukimit dhe departament raportojnë mbi indikatorët e matjes (KPI).
- Feedback i palëve të interesuara: studentët, stafi akademik dhe komuniteti përfshihen përmes forumeve dhe anketave.

- Indikatorët e monitorimit
- Kënaqësia e studentëve dhe stafit matet me anketa periodike (target $\geq 80\%$ deri në 2030).

Rezultatet e pritshme

- *Rezultatet afatmesme (2025–2030)*
 - Infrastrukturë moderne dhe funksionale duke garantuar mjedise të përshtatshme për mësimdhënie dhe kërkim.
 - Rritja e atraktivitetit të universitetit: më shumë studentë nga Shqipëria dhe nga rajoni zgjedhin UAMD si destinacion studimi.
- *Përfitimet për palët e interesuara*
 - Studentët: kushte më të mira mësimi dhe jetese, akses në teknologji, hapësira inovacioni dhe mundësi punësimi.
 - Staf akademik: laboratorë modernë, mbështetje për kërkimin dhe mundësi bashkëpunimi ndërkombëtar.
 - Komuniteti lokal: rritje e aktiviteteve kulturore, ekonomike dhe sociale të lidhura me kampusin.

11.5. Impaktet kryesore strategjike

- Akademik: rritja e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit dhe internacionalizimit të universitetit.
- Social: përmirësimi i jetës studentore, përfshirja e komunitetit dhe krijimi i një kulture të re akademike.
- Mjedisor: krijimi i një mjedisi të shëndetshëm.


XII. Plani për Digjitalizimin

Laboratorët IT shpesh përdoren si qendra praktike për orët mësimore nga studentët dhe pedagogët për të mundësuar zhvillimin në aftësi teknike dhe jo vetëm, gjë kjo e cila lidhet ngushtë me teknologjitë e reja dhe me metodologjinë më bashkëkohore të nxënies. Aktualisht në FE gjenden: Laboratori IDEA dhe pritjet Blendedu Lab brenda 2026.



12.1. Çfarë duhet për të ardhmen?

- Infrastrukturë e avancuar ku përfshin pajisje moderne, rrjet i fuqishëm dhe hapësira për laboratorë bashkëkohor.
- Laboratore digjitale të specializuar për inteligjencë artificiale
- Platforma digjitale për mësim: LMS (learning management system) si Moodle.
- Integrim me cloud: studentët dhe stafi i FE të kenë mundësi për të aksesuar në distancë në laboratorë dhe materiale nga distanca.



Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies:

- Blended Learning: kombinimi i mësimin në klasë dhe online
- Project based learning: studentët punojnë në projekte reale duke përdorur laboratorët ekzistuese por jo vetëm.

Përfitimet për studentët dhe stafin:

- Studentëve ju jep mundësi të zhvillojnë aftësi praktike, të përgatiten për tregun e punës, mësojnë më shpejt dhe në mënyrë më interaktive.
- Stafit i mundësohen mjete të avancuara për mësimdhënie, kohë më eficiente si dhe mundësi për të krijuar materiale digjitale që mund të aksesohen në të ardhmen.

Plan Zhvillimi: Trajnim i stafit akademik dhe administrativ për përdorimin e teknologjive dhe metodave të reja. Integrimi gradual në kurrikulën ku për çdo lëndë, të ketë elemente digjitale dhe praktike.

12.2. Digjitalizimi i integruar akademik dhe kërkimor- shkencor

Digjitalizimi si pjesë e strategjisë institucionale synon gjithashtu të lidhet me:

- krijimin e një Research Repository institucional (Open Science);
- një dashboard digjital për matjen e performancës akademike dhe kërkimore-shkencore.
- sistemet e integruara për ECTS, DS dhe indikatorët e rankimit.

XIII. Zhvillimi i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës në harmoni me Strategjinë e Qytetit të Durrësit, Rajonit dhe më gjerë

Qyteti i Durrësit, si porti më i madh i vendit dhe një nga qendrat më të vjetra urbane të Mesdheut, përbën një hapësirë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik, kulturor dhe mjedisor të Shqipërisë. Me pozicionin e tij strategjik në Adriatik, Durrësi po transformohet në një nyje të rëndësishme ndërkombëtare të transportit, turizmit dhe inovacionit.

Në këtë kontekst, Fakulteti i Edukimit, si një nga njësitë kyçe akademike të UAMD-së, ka një

rol të drejtpërdrejtë në zhvillimin arsimor, social dhe kulturor të qytetit të Durrësit, rajonit dhe më gjerë.

Në këtë kuadër, zhvillimi i Fakultetit do të orientohet nga:

- Strategjitë vendore të zhvillimit arsimor dhe kulturor të Bashkisë Durrës
- Nevojat e tregut rajonal të punës në sektorin e arsimit dhe shërbimeve sociale
- Politikat kombëtare për arsimin parauniversitar
- Objektivat evropiane për transformimin digjital dhe arsimin gjithëpërfshirës

Fakulteti i Edukimit do të veprojë si urë lidhëse midis arsimit të lartë dhe institucioneve të përkujdesit, institucioneve parashkollore dhe atyre të arsimit parauniversitar. Po kështu FE do të veprojë dhe si aktor aktiv në zhvillimin e kapitalit njerëzor qytetar, vendor dhe rajonal.

13.1. Lidhja me Strategjitë Kombëtare dhe Evropiane

Strategjitë Kombëtare të Zhvillimit

Plani i Zhvillimit është në përputhje të drejtpërdrejtë me dokumentet strategjike kombëtare të miratuara nga Qeveria Shqiptare, përfshirë:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 - 2030 (SKZHI 2030) – e cila thekson rëndësinë e arsimit, kërkimit dhe inovacionit si baza të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror.
https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_538_Draft-Strategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf
- Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë 2021-2026: që nxit ndërveprimin universitet-treg pune dhe ndërkombëtarizimin e arsimit. <https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/>
- Dokumenti i Politikave të Arsimit të Lartë 2030: i cili është pjesë e kuadrit strategjik të arsimit dhe synon zhvillimin e arsimit të lartë bashkë me standardet ndërkombëtare dhe integrimin në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Ky dokument përshkruan angazhimin për përmirësimin e cilësisë, përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe integrimin e arsimit të lartë në proceset evropiane dhe të zhvillimit të vendit deri në vitin 2030. <https://www.kryeministria.al/en/newsroom/dokumenti-i-politikave-te-arsimit-te-larte-2030-per-arsimin-e-larte-ne-harmoni-me-standardet-nderkombetare-mbeshtetes-i-procesit-te-integrimit-dhe-zhvillimit-te-vendit>

Në këtë mënyrë, FE përputhet me prioritetet kombëtare për:

- Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social;
- Rritje të konkurrueshmërisë përmes inovacionit;
- Përmirësim të cilësisë së arsimit dhe punësimit të rinjve;
- Digjitalizim dhe transformim teknologjik të institucioneve publike.

13.2. Strategjitë dhe Objektivat Evropiane

Në nivel evropian, FE e orienton zhvillimin e vet në përputhje me:

- Council Resolution on a strategic framework for European cooperation in education and training towards the European Education Area and beyond (2021–2030) — rezoluta e Këshillit të Bashkimit Evropian që vendos Strukturën Strategjike për Bashkëpunimin Evropian në Arsimin dhe Trajnimin 2021–2030.

Ky është dokumenti themelor që përkufizon procesin drejt European Education Area dhe objektiva të përgjithshëm deri në 2030, përfshirë edhe arsimin e lartë. https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=oj:JOC_2021_066_R_0001&utm_source=chatgpt.com

- Programet Horizon Europe dhe Erasmus+ – ku FE synon rritjen e pjesëmarrjes në konsorciume kërkimore dhe mobilitete ndërkombëtare.

Përmes këtyre lidhjeve strategjike, FE synon të pozicionohet si një aktor i integruar në hapësirën akademike evropiane dhe si promotor i zbatimit të politikave të Gjelbërta e Dixhitale në Shqipëri.

13.3. Roli i Fakultetit në Zhvillimin e Qytetit të Durrësit

Mbështetja e shërbimeve të përkujdesit social, arsimit parashkollor dhe parauniversitar

Fakulteti do të:

- Forcojë bashkëpunimin me shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit.
- Organizojë trajnime periodike për mësuesit në shërbim.
- Ofrojë kredite për zhvillim profesional të mësuesve.
- Forcojë bashkëpunimin me institucionet parashkollore
- Forcojë bashkëpunimin me institucionet e përkujdesit për 0-3 vjeç dhe qendrat e trajtimit dhe të kujdesit për të moshuarit
- Realizojë praktika profesionale të strukturuar në shkollat e Durrësit, institucionet e përkujdesit për 0-3 vjeç dhe qendrat e trajtimit dhe të kujdesit për të moshuarit.

Qëllimi është që Fakulteti të bëhet qendër referimi për inovacionin pedagogjik në qytet.

Kontributi në zhvillimin social dhe kulturor

Fakulteti i Edukimit me të gjitha departamentet e tij angazhohet se do të:

- Organizojnë aktivitete kulturore, letrare dhe gjuhësore në bashkëpunim me bibliotekat dhe institucionet kulturore lokale.
- Promovojnë trashëgiminë kulturore dhe identitetin lokal.
- Zhvillojnë kurse të gjuhës shqipe për të huaj.
- Ofrojnë studime dhe analiza mbi problematika sociale lokale.
- Bashkëpunojnë me institucionet sociale dhe OJF-të.
- Ofrojnë shërbime këshillimi psikologjik për komunitetin.

Zhvillimi në harmoni me rajonin: përgjigjja ndaj nevojave rajonale

Rajoni i Durrësit dhe qarku përreth përballen me:

- Nevojë për mësues të kualifikuar.
- Nevojë për ekspertizë në edukim inkluziv.
- Sfidat e migracionit dhe diversitetit kulturor.
- Rritjen e problematikave të shëndetit mendor në shkolla.

Fakulteti i Edukimit do të:

- Rrisë cilësinë e programeve në edukim gjithëpërfshirës.
- Forcojë programet në psikologji shkollore.
- Zhvillojë kërkime mbi sfidat arsimore rajonale.

Bashkëpunimi me institucionet rajonale

Fakulteti i Edukimit do të formalizojë marrëveshje bashkëpunimi me:

- Drejtoritë Rajonale të Arsimit
- Bashkitë e rajonit
- Qendrat e shërbimeve sociale
- Organizata rinore dhe kulturore

Këto bashkëpunime do të mundësojnë:

- Praktika profesionale cilësore
- Projekte të përbashkëta kërkimore
- Studime ndikimi mbi politikat arsimore lokale

13.4. Dimensioi Kombëtar dhe më gjerë: kontributi në reformën arsimore kombëtare

Fakulteti i Edukimit do të:

- Kontribuojë në hartimin dhe vlerësimin e kurrikulave kombëtare.
- Ofrojë ekspertizë në proceset e reformës arsimore.
- Bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit për trajnime dhe politika zhvillimore.

Ndërkombëtarizimi në Funksion të Zhvillimit Lokal

Ndërkombëtarizimi nuk shihet si qëllim në vetvete, por si mjet për:

- Transferimin e praktikave më të mira evropiane në shkollat shqiptare.
- Zhvillimin e moduleve në gjuhë të huaja.
- Përfshirjen në projekte Erasmus+, Horizon Europe dhe rrjete akademike.
- Rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit.

Përmes këtij dimensionit, Fakulteti do të bëhet aktor rajonal me ndikim ndërkombëtar.

Qëllimet Strategjike të Fakultetit

1. Të shndërrohet në qendër referimi për zhvillimin profesional të mësuesve në rajon.
2. Të kontribuojë aktivisht në zhvillimin social dhe kulturor të qytetit.
3. Të integrojë kërkimin shkencor me problematikat reale të komunitetit.
4. Të ndërtojë partneritete të qëndrueshme rajonale dhe ndërkombëtare.

5. Të fuqizojë rolin e studentëve si kontribues aktivë në komunitet.

Indikatorët e Performancës (KPI)

Objektivi	Indikatori	Afati
Marrëveshje me institucione	≥ 20 marrëveshje aktive	2027
Trajnime për mësues	≥ 10 trajnime	2026–2030
Projekte komunitare	≥ 5 projekte	2028
Studime rajonale të publikuara	≥ 3	2028
Partneritete ndërkombëtare aktive	≥ 5	2030

Ndikimi i Pritur

Përmes këtij orientimi strategjik, Fakulteti i Edukimit do të:

- Rrisë cilësinë e arsimit në qytet dhe rajon.
- Ndihmojë në zhvillimin e kapitalit njerëzor lokal.
- Forcojë lidhjen midis universitetit dhe komunitetit.
- Kontribujë në zhvillimin e qëndrueshëm arsimor dhe social.

Dimensioni Social dhe Edukativ

Objektiva:

2028: themelimi i Qendrës për Mësim gjatë Gjithë Jetës.

2030: zhvillimi i programeve të orientimit në karrierë për shkollat e mesme.

2040: UAMD të bëhet model kombëtar për përfshirjen sociale dhe arsimin gjithëpërfshirës.

Internacionalizimi dhe Rrjetëzimi Rajonal

Objektiva:

2030: dyfishimi i mobiliteteve Erasmus+.

2035: nënshkrimi i programeve të përbashkëta master/doktorature.

Indikatorët e Suksesit

70% e të diplomuarve, të punësuar në institucionet e qytetit dhe rrethinat deri në 2040.

Rritje me 50% e bashkëpunimeve ndërkombëtare në kërkim.

100% e fakultetit e përfshirë në programe të qëndrueshmërisë.

Ky plan përbën një vizion afatgjatë për integrimin e FE-së në strukturën zhvillimore të qytetit dhe rajonit. Ai forcon lidhjen midis dijes, inovacionit dhe praktikës, duke e shndërruar fakultetin në një aktor kyç të zhvillimit rajonal, social dhe edukativ.

FE do të jetë një fakultet modern, ndërkombëtar dhe i hapur, në shërbim të qytetarëve dhe brezave të ardhshëm të Durrësit.